

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5665
E premte, 28 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

Presidenti shpreson në bashkimin e Luginjës së Preshevës me Kosovën



FAQE 3

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



DY KADETË TË FSK-SË DIPLOMOJNË NË AKADEMINË USHTARAKE TË GJERMANISË F. 6

QUINTI MBËSHKETET KOSOVËN NË DIALOG ME SERBINË F. 7

AVOKATI I POPULLIT PÛRKRAH VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE F. 6

EKONOMI

HAMZA: 2018-A, VIT I SUKSESSHËM PÛR MINISTRINË E FINANCAVE F. 9

BEQAJ: MINISTRIA E INOVACIONIT KA ARRITUR QË KOSOVËN TA BËJË PJESE TË AGJENDËS DIGJITALE TË KE-së F. 9

REÇICA NUMËRON TË ARRITURAT E MPMS-së PÛR VITIN 2018 F. 8

SPORT

GASHI: BESA NUK KA KRIZË, RIKTHEHET NË SUPERLIGË F. 18

SHAQIRI MERITOR PÛR FORMËN E LARTË TË LIVERPOOLIT F. 18

FLET PÛR "EPOKËN E RE", RRAHMAN JASHARAJ F. 4-5

Më 14 janar nis greva nëse nuk realizohen kërkesat e SBASHK-ut

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka bërë me dije se greva njëorëshe e së enjtes është alarmi i fundit për institucionet e Kosovës për realizimin e kërkesave të punëtorëve në sistemin arsimor. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se gjysmëvjetori i dytë i vitit shkollor mund të fillojë me grevë të përgjithshme dhe me kohë të pacaktuar nëse nuk realizohen kërkesat e SBASHK-ut. Jasharaj ka treguar se për SBASHK-un është i papranueshëm trajtimi që i është bërë arsimit në Projektligjin për pagat. Sipas tij, mësimdhënësit janë duke kërkuar vendin meritë në këtë projektligj

Vritet polici në detyrë duke mbrojtur qytetarët

Izet Demaj, pjesëtar i Policisë së Kosovës, është vrarë të enjten në qytetin e Istogut derisa ndihmonte qytetarët e marrë pengë nga personi që kishte organizuar grabitjen në Bankën NLB. Grabitësi, në përpjekje për t'u larguar nga vendi i ngjarjes, ka shtënë me armë drejt zyrtarëve policorë, të cilët, në vetëmbrojtje të vetes dhe të qytetarëve, janë detyruar t'i kundërpërgjigjen me armë zjarri, duke e lënë të plagosur grabitësin i cili më pas ka ndërruar jetë. Polici Izet Demaj ka qenë edhe ushtar i UÇK-së F. 8-9



Nesër numri festiv i 'Epokës së re;



Nesër (e shtunë) gazeta "Epoka e re" do ta botojë numrin festiv, në të cilin do të ketë shkrime ekskluzive, intervista dhe opinione nga politika, ekonomia, arsimit, kultura dhe sporti. Brenda këtij numri festiv "Epoka e re" sjell për lexuesit edhe një kalendar ekskluziv me pamje nga ushtria e Kosovës

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta: Diaspora të protestojë te Presidenca

TIJANË, 27 DHJETOR - Duke folur të enjten nga Korça në një aktivitet në Universitetin "Fan Noli", presidenti Ilir Meta tha se është shpërdoruar mjaft kohë dhe energji tepër e dobishme për t'i dhënë një zgjidhje të besueshme dhe afatgjatë problemeve të arsimit të lartë dhe studentëve. "Do të mbështesja çdo reflektim të sinqertë, të thelluar dhe të qëndrueshëm dhe konstruktiv në këtë drejtim. Problemi zgjidhet vetëm në këtë mënyrë, përmes një dialogu të sinqertë, jo pro-

vokues, jo ndarës, jo intimidues dhe përmes një bashkëpunimi të besueshëm dhe konstruktiv", u shpreh Meta.

Sa i takon refuzimit të lejes së Policisë për protestën e diasporës para Kryeministrit, ai tha se shqiptarët kanë protestuar edhe në diktaturë, pavarësisht nga kostot e tmerrshme që kanë paguar. "Nuk besoj që një gjë e tillë mund të ketë ndodhur. Sa e zëmë se ka ndodhur. Janë të ftuar të gjithë emigrantët që të protestojnë në oborrin brenda

Presidencës", deklaroi kreu i shtetit. Ai komentoi dhe vendimet e fundit të qeverisë lidhur me kërkesat dhe protestat e studentëve. "Besoj se është shpërdoruar mjaft kohë e energji tepër e dobishme për të dhënë një zgjidhje të besueshme dhe afatgjatë problemeve të arsimit të lartë dhe studentëve. Unë do të mbështesja çdo reflektim të sinqertë të thelluar të qëndrueshëm në këtë drejtim, që do të thotë se problemi zgjidhet vetëm përmes dialogut të sinqertë, jo pro-



vokues, jo ndarës, as intimidues dhe përmes një bashkëpunimi të besueshëm dhe konstruktiv", tha Meta.

Ahmeti: Kosova dhe Serbia të arrijnë zgjidhje të dobishme

Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, në fjalimin mbajtur me rastin e fundvitit, ka thënë se të gjithë e dinë se ende ka mbetur një vrimë e zezë pa u rregulluar problemi Kosovë - Serbi. "Unë nuk mund të jem indiferent ndaj këtyre zhvillimeve, mbase kam edhe nostalgji, sepse organizimi im profesional e funksional filloi në hapësirat e Kosovës", ka thënë Ahmeti



SHKUP, 27 DHJETOR - Lideri i Bashkimit Demokratik për Integritet, Ali Ahmeti, në fjalimin mbajtur me rastin e fundvitit para anëtarëve të partisë, tha se kemi pasur fillimvit të vështirë, por me të suksesshëm. "Ju e shihni që para jush dhe pas nesh janë shtyllat e të arriturave tona duke filluar që nga ftesa për në NATO dhe fillimi apo lajmi i mirë për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE, Ligji për gjuhët, si një e arritur e pakontestueshme, marrëdhëniet me fqinjët. BDI-ja gjithmonë ka investuar që në hapësirat e Evropës Juglindore të dominojnë paqja, stabiliteti, siguria. Kemi pasur kontakte me funksionarë të institucioneve bullgare dhe kjo marrëveshje u arrit", tha lideri i BDI-së.

Ai shtoi se kanë pasur takime të shumta edhe me autoritete nga pala greke. "Ne kemi qenë palë për ta kompletuar procesin, ne kemi qenë pala inkurajuese dhe kontribuuese që kontestet

me palën greke njëherë e përgjithmonë të mbyllen dhe kjo marrëveshje u arrit në Prespë. Rajoni ka nevojë për më shumë paqe, stabilitet, siguri, mirëqenie e ardhmëri. Në vrullin e sipër janë procese të rëndësishme që e forcojnë, kontribuojnë në paqen e stabilitetit rajonal. Të gjithë e dinë se ende ka mbetur një vrimë e zezë pa u rregulluar problemi Kosovë - Serbi. Ne i inkurajojmë palët të gjejnë energji dhe të arrijnë një zgjidhje të dobishme. Unë nuk mund të jem indiferent ndaj këtyre zhvillimeve, mbase kam edhe nostalgji sepse organizimi im profesional e funksional filloi në hapësirat e Kosovës", tha Ahmeti.

Ne këtu në Maqedoni, tha lideri i BDI-së, ndodhemi në fund të përmbylljes së një procesi, jemi në minutat e fundit të një loje të madhe, jemi në momentin ku do të regjistrohet suksesi dhe të na vendosë në krye të tabelës. "Edhe pse është një

proces delikat, do ta përshkruaj si lindje e një foshnje që do kujdes gjatë trajtimit sepse çdo pakujdesi mund t'i dredhë qoftë palcën ose qafën. Dhe kjo foshnje në lindje kërkon trajtim për rritje, ambient shumë të sigurt që të kemi energji dhe kapacitet që këtë proces mos ta lëmë as në mëshirë të fatit, e as të sehirxhinjve. Andaj bëjmë thirrje që opozitës së të dy anëve të kyçen në lojën vendimtare për suksesin përfundimtar. Me 9 janar fillon

seanca për ndërtimin e historisë më të re të këtij shteti të organizuar dhe pranuar nga të gjitha strukturat NATO, BE, në miqësi dhe harmoni me të gjitha vendet e rajonit. Prandaj opozita nga të dyja anët mos ta shfrytëzojë këtë situatë kaq të rëndësishme dhe vendimtare për kredibilitetin e vet politik e partiak, sepse në këtë situatë nuk është momenti që ne të shfrytëzojmë këto momente të rëndësishme për zgjerim dhe rritje të partive politike dhe

këtë moment vendimtar, moment historik i papërsëritshëm vendoset për ardhmërinë të brezave të tërë, vendoset për një shtet të nderuar dhe respektuar nga të gjithë, nga vendorët e deri tek ndërkombëtarët. Ne nuk lindëm as nga salonet e as nga ekranet televizive, ne lindëm si nevojë e kombit shqiptar dhe me përkushtim jemi përpjekur që këtij misioni t'i dalim zot dhe jemi treguar dalzotës të vërtetë", tha Ahmeti.

Komandanti i FSK-së dhe ai i KFOR-it pajtohen për thellimin e bashkëpunimit

Prishtinë, 27 dhjetor (ER) - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjeneralëjtënant Rrahman Rama, ka pritur të enjten në një takim njohës komandantin e ri të KFOR-it, gjen-

eralmajor Lorenzo D'Addario. Fillimisht gjeneralëjtënant Rama e ka uruar komandantin e KFOR-it për detyrën e re. Ai ka njoftuar komandantin e KFOR-it me zhvillimet e fundit rreth miratimit të lig-

jeve për misionin të ri të FSK-së. Më tutje, Rama e ka falënderuar NATO-n/KFOR-in për bashkëpunimin e vazhdueshëm, i cili është realizuar në fusha të ndryshme. Gjatë takimit, të dy

gjeneralët kanë vlerësuar lart bashkëpunimin e FSK-së me KFOR-in dhe kanë shprehur gatishmëri për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.



Presidenti shpreson në bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka përsëritur të enjten idenë e tij që Lugina e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit t'i bashkohen territorit të Kosovës. Ai ka thënë se mbështet plotësisht të drejtat kombëtare të Luginës. Sipas Thaçit, në muajt e ardhshëm shpreson në zyrtarizimin e të drejtës së shqiptarëve të Luginës për bashkëngjitje me Kosovën

ane", ka thënë Thaçi. Ai ka përsëritur idenë që Lugina e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit t'i bashkohen territorit të Kosovës. "Unë i mbështes plotësisht të drejtat kombëtare të Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit. Në muajt në vijim shpresoj në zyrtarizimin e të drejtës së tyre për bashkëngjitje me Kosovën", u shpreh Thaçi.

Presidenti Thaçi ka ftuar të gjithë t'i bashkohen procesit të dialogut me Serbinë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe në fund të arrihet marrëveshja, e cila, sipas presidentit, ka mbështetjen e plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Pas letrës së presidentit (Donald) Trump, gjithçka është e qartë. ShBA-ja ka mbështetje të plotë, një mbështetje që ka ardhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga njeriu numër një, njeriu më i fuqishëm në botë, presidenti i ShBA-së. Nuk ka më dilemë se a e mbështet ShBA-ja këtë proces. Përkundrazi, theksoj, uroj të jemi të bekuar që kjo marrëveshje të bekohet nga presidenti Trump në Shtëpinë e Bardhë", ka deklaruar Thaçi.

Duke komentuar deklaratat e homologut të tij serb, Aleksandar Vuçiq, se dialogu në Bruksel nuk mund të rinisë pa heqjen e taksës doganore që Qeveria e Kosovës ka vendosur ndaj produkteve serbe, presidenti Thaçi ka thënë se kushtëzimet nuk mund të jenë në favor të askujt. "As Kosova nuk duhet ta vështirësojë fillimin e dialogut, as Serbia nuk duhet ta kushtëzojë fillimin e dialogut", është shprehur Thaçi.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur të enjten konferencën e fundvitit me gazetarë, në të cilin ka ritheksuar se Kosova është e gatshme për dialog me Serbinë dhe për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe balancuese. Ai ka thënë se kjo marrëveshje do të jetë në interes të paqes. "Ne do të punojmë shumë seriozisht si Kosovë, duke iu përgjigjur nevojave të vendit për fqinjësi të mirë, që në muajt në vijim të ndodhë dialogu me Serbinë dhe të arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjërish obliguese, që Kosova ta fitojë njohjen nga Serbia dhe anëtarësim në OKB", ka thënë Thaçi. Sipas Thaçit, me arritjen e marrëveshjes Kosova do ta fitojë njohjen nga Serbia si dhe nga pesë vendet e Bashkimit Evropian, që deri më tani nuk e kanë njohur Kosovën. Por, Thaçi përmendi edhe pasojat me të cilat do të përballlet Kosova nëse marrëveshja nuk arrihet. "Kosova e fiton njohjen nga Serbia, e fiton njohjen nga

pesë vendet e Bashkimit Evropian nëse arrihet marrëveshja dhe unë shpresoj se do të arrihet dhe besoj në këtë drejtim. E fiton njohjen globale sepse do të jetë pjesë e Organizatës së Kombeve të

Bashkuara, do të bëhet pjesë e të gjitha organizatave ndërkombëtare dhe e fiton vendin e sigurt për NATO dhe BE. Çka nëse nuk arrin marrëveshje me fajin e vet? E fiton një izolim të plotë ndërkombëtar, regres, papunësi

dhe gjendje që nuk e meritojnë qytetarët e Kosovës. Prandaj, asnjë lider i vendit nuk bën ta mbajë peng të drejtën e qytetarëve të Kosovës dhe dëshirën e qytetarëve që të lëvizet sa më shpejt drejt së ardhmes evropi-

Nesër numri festiv i 'Epokës së re'

Nesër (e shtunë) gazeta "Epoka e re" do ta botojë numrin festiv, në të cilin do të ketë shkrime ekskluzive, intervista dhe opinione nga politika, ekonomia, arsimit, kultura dhe sporti. Në këtë numër festiv dhe ekskluziv të "Epokës së re" flasin liderët e institucioneve të vendit, ata partiakë, përfaqësues të shoqërisë civile, personalitete nga kultura dhe arti, si dhe personalitete nga sporti. Gjithashtu, në këtë numër festiv do t'i lexoni ngjarjet më të veçanta që kanë ndodhur në Kosovë gjatë vitit 2018 dhe në botë. Po ashtu, do të ketë shkrime të ndryshme rreth aktualitetit në Kosovë dhe në botë. Brenda këtij numri festiv "Epoka e re" sjell për lexuesit edhe një kalendar ekskluziv me pamje nga ushtria e Kosovës.



Flet për "Epokën e re", Rrahman Jasharaj

Më 14 janar nis greva nëse nuk realizohen kër

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka bërë me dije se greva njëorëshe e së enjtes është alarmi i fundit për institucionet e Kosovës për realizimin e kërkesave të punëtorëve në sistemin arsimor. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se gjysmëvjetori i dytë i vitit shkollor mund të fillojë me grevë të përgjithshme dhe me kohë të pacaktuar nëse nuk realizohen kërkesat e SBASHK-ut. Jasharaj ka treguar se për SBASHK-un është i papranueshëm trajtimi që i është bërë arsimit në Projektligjin për pagat. Sipas tij, mësimdhënësit janë duke kërkuar vendin meritore në këtë projektligj

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 DHJETOR - "Epoka e re": Z. Jasharaj, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) ka paralajmëruar se më 14 janar 2019 do të fillojë greva e përgjithshme në sistemin arsimor. Cilat janë arsyet që ju kanë shtyrë të merrni këtë vendim?

Jasharaj: SBASHK-u në vazhdimësi ka kundërshtuar Projektligjin për paga të cilin e ka konsideruar diskriminim për tërë sistemin arsimor. Jemi munduar që këtë çështje ta rregullojmë me dialog dhe për këtë kemi pasur takime me kryeministrin Haradinaj, me ministrin Bytyqi dhe ministrin Jagxhillar, por as ky dialog nuk i ka dhënë rezultatet e pritura. Më 8 shtator patëm menduar të protestojmë në sheshin "Skënderbeu" me kryetarët e shoqatave sindikale të shkollave dhe të universiteteve, mirëpo patëm marrë premtimin nga kryeministri se sa i përket sistemit arsimor në Komisionin Parlamentar për Administratë do të bëhet një korrigjim i koeficientëve në mënyrë që mësimdhënësit e Kosovës të kenë pozitë meritore në këtë ligj e jo të degradohen. Po ashtu, para dy jave kemi pasur takim me ministrin Bytyqi, ku jemi zotuar se do ta formojmë një komision i cili do ta paraqesë versionin e SBASHK-ut dhe të MASHT-it që është i përafërt në përpjekje për t'i ndryshuar koeficientët për mësimdhënësit dhe të punësuarit e tjerë në sistemin arsimor. Mirëpo, në ditët e fundit kishe lëvizje të përshpejtuara që Projektligjin e pagave të pakorrigjuar ta dërgojnë në Kuvend dhe ta votojnë në të



njëjtën ditë me buxhetin e vitit 2019. Prandaj të enjten në tërë sistemin arsimor, në çerdhe, në arsimin fillor e të mesëm, por edhe në njësitë akademike të universiteteve të Kosovës është mbajtur greva njëorëshe, së cilës i janë përgjigjur mbi 99 për qind e institucioneve arsimore. Nëse greva e së enjtes që ishte paralajmërimi i fundit nuk ndikon dhe nuk kuptohet drejt nga institucionet e Kosovës, pra nuk korrigjohet Projektligji për pagat, atëherë më 14 janar kur do të duhej të fillonte gjysmëvjetori i dytë, nuk do ta fillojmë me mësim, por me grevë të përgjithshme dhe në kohë të pacaktuar.

"Epoka e re": Mendoni se është i mjaftueshëm ky afat?

Jasharaj: I kemi dhënë afat mjaft të madh dialogut dhe kemi bërë përpjekje të shumta, madje nuk kemi lënë derë pa trokitur. Kemi biseduar me deputetët, me koordinatoren nacional për reforma shtetërore, i kemi dërguar letër Komisionit për Administratë tek i cili është aktualisht projektligji dhe kemi kërkuar që në punimet e këtij komisioni të ftohet SBASHK-u dhe MASHT-i sepse kemi argumente të cilat dëshmojnë se sistemi arsimor po degradohet edhe me paga. Nuk ka kuptim që shoferët e udhëheqësve të kenë pagë më të lartë se profesorët tanë të cilët kanë ngrit-

je akademike. Projektligji për paga nuk ka bërë nivelizim të pagave, por ka bërë një thellim të diferencave në mes të pagave. Nuk po flas për pagat e drejtuesve të shtetit, deputetëve e ministrave sepse edhe më herët kanë qenë më paga më të larta se të gjithë të tjerët, por edhe brenda sektorëve ka dallime. Bie fjala, një psikolog i klinikës dhe një psikolog në shkollë, të cilët kanë titull të njëjtë, sipas këtij projektligji, psikologu i klinikës do të ketë pagë mbi 800 euro, kurse psikologu i shkollës mbi 400 euro. Sipas versionit aktual të Projektligjit për paga, më i nënçmuari dhe dëmtuari është sistemi arsimor. Më ulët se ne nuk ka

mbetur askush përveç profesionet për të cilat kërkohet arsimimi i mesëm dhe fillor.

"Epoka e re": SBASHK-u në asnjë formë nuk do të pajtohet me koeficientët që janë paraparë në këtë projektligj?

Jasharaj: SBASHK-u nuk po pajtohet me të gjithë këto dallime brenda institucioneve publike. Nuk po kërkojmë as më shumë e as më pak sesa një vend meritore. Të tjerët duhet t'i kthejnë sytë kah arsimi dhe mësimdhënësit sepse ata ua mësojnë fëmijët udhëheqësve politike, mjekëve, policëve dhe të tjerëve. Me mësues të çmotivuar nuk mund të priten angazhime që ata të tregojnë

kesat e SBAShK-ut



het të mjaftueshëm që shkollat të furnizohen me mjete bashkëkohore të punës. Mësimdhënësit në garën për cilësinë më të lartë shpesh i kemi lënë vetëm duke mos u krijuar kushte optimale të punës sepse ka kaluar koha kur arritjet mund të jenë të larta duke punuar me shkumës, shpuzë dhe tabelë, madje tabelat në disa shkolla nuk janë ndërruar me vite të tëra. Shteti duhet të ndajë buxhet më shumë për t'iu krijuar kushte më të mira dhe t'i mbështesë mësimdhënësit në mënyrë që të gjithë së bashku të angazhohemi për arritje më të larta. Mësuesi ka mbetur shpesh vetëm në këto përpjekje, prandaj e ka vështirë të krijojë arritje më të larta edhe pse ata janë të devotshëm dhe bëjnë përpjekje për këtë. Pa u krijuar kushte nuk mund të arrihet shumë. Po ashtu, kurrikula është e re dhe është tepër e vështirë për t'u realizuar. Përmbajtja e teksteve ka mbetur e vjetër, ndërsa kurrikula është e re dhe nuk korrespondon teksti shkollor me kërkesat e kurrikules. Ka edhe çështje të tjera dhe nuk dua t'i mbroj mësimdhënësit, por ata duhet të ndihmohen duke u krijuar kushte optimale.

"Epoka e re": Kryetar, kjo greva e paralajmëruar për 14 janar a do të mund të ndikojë negativisht në sistemin arsimor dhe a mendoni se nuk ka hapësirë për ndonjë kompromis?

Jasharaj: Mendojmë se ende ka kohë për negociata sepse vetë fakti që ne e realizuam grevën njëorëshe është alarmi i fundit dhe deri më 14 janar institucionet kanë kohë për të reflektuar në mënyrë që të ulemi së bashku dhe të gjejmë një zgjidhje të pranueshme. SBAShK-u nuk po kërkon diçka që nuk mund të realizohet, por kafshata që ndahet duhet të jetë e barabartë për të gjithë. Pra, nuk është në rregull që disa sektorëve t'u plotësohen të gjitha kërkesat, ndërsa arsimit të mos i plotësohet asnjë kërkesë. Po kërkojmë barazi dhe vend meritë në ligjin e pagave. Mësuesi duhet të ketë tretman në shoqëri, pastaj të kërkohej nga ai punë dhe rezultate. Nëse institucionet nuk reagojnë, nuk kemi zgjidhje tjetër. Jemi të vetëdijshëm se greva e përgjithshme në kohë të pacaktuar do ta destabilizojë procesin mësimor, mirëpo për këtë përgjegjësinë e kanë institucionet sepse ne kemi bërë të pamundurën për ta arritur zgjidhjen e çështjeve me dialog. Kërkesat e SBAShK-ut duhet të realizohen sepse janë të ligjshme. Edhe kryeministri Haradinaj edhe ministri Bytyqi publikisht e kanë thënë se koeficientët aktualë nuk janë në rregull dhe se arsimi nuk e meriton pozitën që e ka në Projektligjin për paga, por e meriton një vend meritë.

rezultate edhe më të mëdha në të ardhmen.

"Epoka e re": Vitet e fundit ka rënë shumë cilësia në arsim. Ka ndikuar në këtë drejtim trajtimi që u është bërë mësimdhënësve sa iu përket pagave?

Jasharaj: Jo, mësimdhënësit e Kosovës janë dëshmuar edhe në kohë shumë më të vështira se nuk e kanë primare pagën, por as nuk pranojnë të jenë të degraduar karshi të tjerëve. Nëse nuk do të kishte mundësi që të lëvizin koeficientët për askënd, as mësimdhënësit dhe punëtorët e tjerë nuk do të reagonin. Cilësia është e tillë sepse shteti, edhe pse thotë se e ka prioritet arsimin, nuk ndan bux-

Vritet polici në detyrë duke mbrojtur qytetarët

Izet Demaj, pjesëtar i Policisë së Kosovës, është vrarë të enjten në qytetin e Istogut derisa ndihmonte qytetarët e marrë peng nga personi që kishte organizuar grabitjen në Bankën NLB. Grabitësi, në përpjekje për t'u larguar nga vendi i ngjarjes, ka shtënë me armë drejt zyrtarëve policorë, të cilët, në vetëmbrojtje të vetes dhe të qytetarëve, janë detyruar t'i kundërpërgjigjen me armë zjarri, duke e lënë të plagosur grabitësin i cili më pas ka ndërruar jetë. Polici Izet Demaj ka qenë edhe ushtar i UÇK-së

ISTOG, 27 DHJETOR (ER) - Policia e Kosovës përmes një komunikate për media ka dhënë detaje të enjten për të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur në Istog, ku kanë mbetur të vrarë polici Izet Demaj dhe një grabitës. "Sot, në orën 15:35, në filialin e Bankës së NLB-së në Istog, ka ndodhur një rast tentimgrabitje e armatosur. Njësitet policore kanë ndërmarrë veprimet e menjëhershme policore për t'iu përgjigjur vendit të ngjarjes. Pas arritjes në atë lokacion kanë hasur në personin e dyshuar i cili posedonte një armë zjarri të gjatë, si dhe dyshohej që kishte marrë peng dy persona", është thënë në njoftimin e policisë.

Policia sqaron se personi i dyshuar, në përpjekje për t'u larguar nga vendi i ngjarjes, ka shtënë me armë zjarri drejt zyrtarëve policorë, të cilët në vetëmbrojtje të vetes dhe të qytetarëve janë detyruar t'i kundërpërgjigjen me armë zjarri, duke e neutralizuar dhe duke e lënë të plagosur personin e dyshuar. Sipas këtij njoftimi, polici Izet Demaj ishte plagosur rëndë dhe kishte kërkuar ndihmë në spitalin rajonal të Pejës. "Gjatë intervenimit policor, si pasojë e shkëmbimit të armëve të zjarrit, një zyrtar policor është plagosur rëndë, dhe i njëjti është dërguar për trajtim mjekësor në spitalin rajonal të Pejës. Disa orë më vonë nga mjekët është konfirmuar vdekja e zyrtarit policor (I. D.) i cili ka shërbyer në Stacionin Policor në Istog, si dhe vdekja e personit të dyshuar (K. M.), viti i lindjes 1968, nga fshati Shushicë e Ulët - Istog", thuhet në njoftimin e policisë. Policia sqaron se të gjitha njësitet policore nga niveli lokal, rajonal



dhe ai qendror kanë dalë në vendin e ngjarjes për t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme policore. "Gjatë ekzaminimit të vendit të ngjarjes, në afërsi është gjetur një granatë dore, një armë zjarri revole dhe një armë AK-47 me municion, të cilat i ka pasur i dyshuari. Nga hetimi i deritanishëm ka rezultuar se personi i dyshuar ka të kaluar kriminale të kryer në disa vende të Evropës", është theksuar në njoftim.

Pas vrasjes së policit në Istog kanë reaguar presidenti i vendit, kryeparlamentari dhe kryeministri, të cilët e kanë dënuar vrasjen e policit. "Kosova, fatkeqësisht, sot e humbi një polic të guximshëm në krye të detyrës. Ngushëllime familjes Demaj dhe Policisë së Kosovës! Izet Demaj është hero i Republikës së Kosovës", ka shkruar presidenti Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli përmes një posti-

mi në "Facebook" ka shkruar se është ndër thellësisht i pikëlluar nga lajmi për vdekjen e policit Izet Demaj. "Ai ra në krye të detyrës, duke mbrojtur me jetën e vet qytetarët dhe pronën e tyre. Në këto çaste të rënda, e gjithë Kosova ndien dhimbje për humbjen e këtij heroi të ligjit", ka shkruar Veseli.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", është shprehur i tronditur pas njoftimit për vrasjen e zyrtarit policor. "I tronditur nga vrasja e pjesëtarit të Policisë së Kosovës në Istog dhe ish-ushtar i luftës sonë çlirimtare, Izet Demaj. Për t'u dalë në ndihmë qytetarëve të marrë peng, gjatë plaçkitjes së një banke sot, pa menduar për veten, fatkeqësisht, ka humbur jetën. Izeti është shembull se si mbrohet jeta e qytetarëve. Ngushëllimet e mia më të thella për familjen Demaj dhe Policinë e Kosovës", ka shkruar Haradinaj.



Dy kadetë të FSK-së diplomojnë në Akademinë Ushtarake të Gjermanisë

PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER) - Kadetët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Art Sahiti dhe Dhurim Shemsedini, ditë më parë kanë diplomuar në Akademinë Ushtarake "Bundeswehr-Offizier Lehrgang" të Republikës Federale të Gjermanisë. Kadetët e FSK-së i kanë përfunduar me sukses studimet trevjeçare në Akademinë Ushtarake më prestigjioze për logjistikë në Gjermani, ku edhe janë graduar në gradën nëntoger. Nëntogerët Art

Sahiti dhe Dhurim Shemsedini, pas përfundimit të Akademisë Ushtarake, janë emëruar në detyra të reja në Brigadën e Mbështetjes Operacionale, në Departamentin e Logjistikës, pasi edhe studimet i kanë mbaruar në këtë fushë.

Të dy nëntogerët e sapo-emëruar në detyrë janë shprehur të kënaqur dhe shumë mirënjohës ndaj FSK-së që ua dha mundësinë për të studiuar në një shtet mik dhe të fuqishëm si Gjermania, e cila

vazhdimisht ka kontribuar për Kosovën dhe në veçanti për FSK-në, duke e ndihmuar në të gjitha fushat si në fushën e arsimit, trajnimeve, logjistikës (pajisje logjistike), mjekësore (pajisje mjekësore), transportit etj.

Akademia "Bundeswehr Offizier Lehrgang" në Gjermani është e njohur për cilësinë e lartë të shkollimit në nxjerrjen e kuadrove profesionale dhe specialistike në degë të ndryshme ushtarake dhe në logjistikë.



Avokati i Popullit përkrah viktimat e dhunës në familje

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Në prag të vitit të ri, zëvendësit e Avokatit të Popullit, Edona Hajrullahu dhe Mehdi Geci, kanë vizituar të enjten Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF), e cila është strehimore për strehimin e viktimave të dhunës në familje, me nivele të ndryshme të rrezikshmërisë. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit u interesuan për punën dhe gjendjen e QMGF-së, duke ofruar gatishmërinë e institucionit që drejtojnë për përkrahje të QMGF-së, e cila strehon një kategoritë rëndë të viktimave të dhunës në familje. Në këtë drejtim është theksuar se IAP-i është duke i bërë hetimet gjithëpërfshirëse ndërlidhur me problemin e dhunës në familje dhe se do të dalë me një raport me rekomandime për institucionet përkatëse, të cilat janë përgjegjëse për përmirësimin e



kushteve në këto qendra të strehimit, si dhe nevojën e vetëdijesimit të shoqërisë për parandalimin e dhunës në familje.

Gjatë kësaj vizite drejtoresha e QMGF-së, Zana Hamiti, ka informuar zëvendësit e Avokatit të Popullit për punën dhe sfidat me

të cilat ballafaqohet kjo qendër. Sipas drejtoreshës së QMGF-së, problemi kryesor është financimi i shërbimeve të qendrës, e cila

shpreson se, pas licencimit nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS), financimi i shërbimeve të QMGF-së do të përmirësohet dhe të ketë financim buxhetor, për të cilën nëpërmjet Rrjetit të Grave është bërë kërkesa buxhetore në institucionet përkatëse për vitin 2019. Ajo ka theksuar se deri më tani burimet kryesore të financimit janë disa institucione ndërkombëtare që përkrahin projektet e QMGF-së si dhe iniciativat humanitare të individëve.

Duke folur për shërbimet e kësaj qendre, Hamiti ka treguar se nga dhjetori i vitit 1999 në këtë qendër janë strehuar afër 1 500 viktimat të dhunës, ndërsa për momentin kapaciteti i strehimoreve me karakter të tipit të mbyllur është për 19 viktimat. QMGF-ja ofron shërbime jo vetëm për viktimat nga Prishtina, por edhe nga komunat që i takojnë regionit të Prishtinës, gjithashtu në rast nevojë edhe nga komunat e tjera.

Universiteti 'Isa Boletini' anëtarësohet në Rrjetin e Universiteteve të Frankofonisë

MITROVICË, 27 DHJETOR (ER) - Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB) është anëtarësuar në Rrjetin e Universiteteve të Frankofonisë, ku bëjnë pjesë universitete, kolegje dhe institute kërkimore. Pas Universitetit të Prishtinës, UMIB-i është universiteti i dytë në rajon që anëtarësohet në këtë rrjet që numëron 884 anëtarë prej 111 shteteve të ndryshme. Rectori Alush Musaj e ka vlerësuar lajm të mirë anëtarësimin e UMIB-it në këtë rrjet, i cili ka

qëllim promovimin dhe përhapjen e gjuhës frënge në të gjithë botën. "Është jashtëzakonisht lajm i mirë për Universitetin tonë që të jemi anëtar i këtij rrjeti që ka si mision edhe këshillimin dhe implementimin e projekteve, eksperimenteve dhe inovacioneve", ka thënë ai. Përpos rrjetit të universiteteve, Rrjeti i Frankofonisë bashkëpunon edhe me institucione shtetërore dhe organizata internacionale. Të qenit anëtar në këtë rrjet mundëson qasje në rrjetin global

të institucioneve anëtare, akademikëve dhe studiuesve frankofonë, mandej pjesëmarrje në projekte ndërmjet institucioneve anëtare si dhe pjesëmarrje në përkatjeten e projekteve. Gjithashtu, anëtarët e këtij rrjeti të themeluar para 50 vjetëve përfitojnë nga mjetet dhe burimet arsimore të përshtatura për nevojat dhe kontekstet rajonale, duke promovuar përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe kërkime etj.



Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe kryesuesit e ekipit negociator të dialogut janë takuar me ambasadorët e shteteve të Quintit

Quinti mbështet Kosovën në dialog me Serbinë



Ambasadorët e Shteteve të Bashkuara, Francës, Gjermanisë, Italisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, i kanë dhënë mbështetje të plotë të enjten Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë. Në takimin që kanë pasur me përfaqësuesit më të lartë të institucioneve të Kosovës dhe kryesuesit të ekipit negocitor, ambasadorët e shteteve të Quintit kanë vlerësuar se Kosova duhet të jetë unike në këtë proces

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Ambasadorët e shteteve të Quintit u kanë dhënë mbështetje të plotë institucioneve të Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë. Në takimin që përfaqësuesit e institucioneve dhe kryesuesit e ekipit negocitor për dialog kanë zhvilluar të enjten me ambasadorët e shteteve të Quintit këta të fundit kanë kërkuar unitet

në këtë proces.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në hapje të takimit me ambasadorët e akredituar në vendin tonë, presidentin Thaçi, kryeministrin Haradinaj dhe anëtarët e ekipit negociator, ka thënë se Kosova është gati për fazën e dialogut final me Serbinë. Ai ka deklaruar se bashkë me aleatët perëndimorë Kosova do të dalë triumfuese, duke siguruar njohjen e pavarësisë nga Serbia, ulësen në OKB dhe përshejtimin

në integritet euroatlantike. "Kosova deri tani që nga koha e luftës ka bashkudhëtuar me aleatët e saj perëndimorë nëpër çdo proces të rëndësishëm. E kaluara na ka treguar që ky bashkudhëtim dhe unitet i spekttrit politik në çështje të mëdha ka rezultuar gjithnjë me fitore për Kosovën. Andaj sot kam vetëm një mesazh të qartë, ne jemi gati dhe jemi bashkë", ka thënë Veseli në këtë takim.

Kurse zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh bashkëkryesues i ekipit negociator, Fatmir Limaj, ka thënë se në takimin me ambasadorët është shprehur gatishmëria e Kosovës për dialogun me Serbinë. "Ambasadorët shprehën përkrahje të plotë dhe natyrisht duan unitet dhe duan ta shohin Kosovën unike dhe mbështesin idetë tona dhe angazhimin tonë në këtë proces. Dhe, si çdoherë, edhe këtë herë po e mbështesin Kosovën, një mar-

rëveshje përfundimtare mes dy vendeve, e cila do të jetë obliguese për të dyja vendet", ka thënë Limaj pas takimit.

Ndërkohë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka theksuar se Kosova ka nevojë për unitet dhe për arritjen e një marrëveshjeje me Serbinë. "Si kryeministër i vendit jam angazhuar që nga fillimi që të ketë dialog përmbajtësor, transparent dhe në interes të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kam angazhuar ekipin më të mirë dhe ekspertë të jashtëm që Kosovës t'ia prezantojnë ekipin negociator dhe dokumentin bazë, librin me shumë kapituj për një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjërish të obligueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka shkruar Haradinaj. Sipas tij, Kosova ka nevojë për unitet dhe unifikim të qëndrimeve të krejt spektarit poli-

tik në vend. "Sot jam i lumtur që kemi ekip negociator dhe që janë aktivizuar edhe mekanizma të tjerë shtetërorë, duke e parë se sa me interes është ky proces, veçmas transparenca dhe përmbajtja e tij. Kosova ka nevojë për unitet dhe unifikim të qëndrimeve të krejt spektarit politik në vend, me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje, që është në përputhje të plotë me vullnetin politik të popullit të Kosovës, të shprehur më 17 shkurt 2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës", ka shkruar Haradinaj.

Ky është takimi i dytë i kësaj natyre i ftuar nga kryeparlamentari Kadri Veseli.

Një ditë më parë, Veseli kishte ftuar në takim vetëm përfaqësuesit e institucioneve të vendit dhe anëtarët e ekipit negociues. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje nuk u janë përgjigjur pozitivisht asnjërit prej këtyre dy takimeve, ndonëse ishin të ftuara.

Oda e Avokatëve do t'i mbrojë falas të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës



PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER) - Jahjaga Foundation dhe Oda e Avokatëve të Kosovës kanë nënshkruar të enjten marrëveshje bashkëpunimi, e cila ka për qëllim mbrojtjen juridike falas për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, ka theksuar se ky është një prej hapave më të rëndësishëm për qasjen në drejtësi për të mbijetuarit e dhunës seksuale pasi, sipas saj, qasja në drejtësi është proces edhe më gjithëpërfshirës. Osman Havolli nga Oda e Avokatëve të Kosovës u shpreh i lumtur për ndihmën që do të ofrojë Oda e Avokatëve të Kosovës përmes avokatëve të cilët do të angazhohen me rastet

meqenëse qasja në drejtësi është qëllim i përbashkët.

Oda e Avokatëve të Kosovës, përmes avokatëve anëtare të saj, do t'i mbrojë falas të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë, duke i përfaqësuar ata para të gjitha instancave të drejtësisë (gjykatave dhe prokurorive) në Kosovë, kurdo që ky proces të fillojë në Kosovë. Mbrojtja falas për të mbijetuarit është pjesë e rëndësishme e qasjes në drejtësi për këtë kategori shoqërore në Kosovë, proces i cili duhet të ndiqet edhe nga shumë hapa të tjerë nga të gjitha institucionet dhe shoqëria e Kosovës në përgjithësi, në mënyrë që të arrihet ky qëllim i përbashkët.

Reçica numëron të arriturat e MPMS-së për vitin 2018

EPOKA E RE**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka mbajtur të enjten konferencën përmblylëse të vitit 2018. Ai foli fillimisht për sfidat dhe obligimet e vitit që po lamë pas si ato në fushën e marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, trajtimit jo të barabartë të personave me aftësi të kufizuara, financimit dhe ndarjes së përgjegjësi për shërbime sociale dhe familjare, si dhe rreth skemave pensionale të financuara nga shteti.

Reçica ka thënë se këto sfida janë adresuar, ku përmendi Strategjinë Sektoriale dhe Planin e Veprimt të MPMS-së, si dhe Planin për Punësimin e të Rinjve, të dy këto dokumente strategjike të miratuara këtë vit në Qeveri, për të vazhduar më tej me reforma në pothuajse të gjithat fushat. "Në kuadër të reformave që kemi ndërmarrë gjatë vitit 2018 është hartuar Projektligji i Punës, Projektligji për Pushimin e Lehonisë dhe Prindëror, Projektligji për Inspektoratin e Punës, konceptdokumenti për reformën pensionale, konceptdokumenti për fushën sociale dhe familjare, si

dhe ai për aftësinë e kufizuar", ka thënë ministri.

Reçica ka shtuar se këto projektligje dhe konceptdokumente parashohin rregullimin e një sërë çështjesh si: avancimin e të drejtave të punëtorëve, trajtimin meritë të nënave lehonë dhe për herë të parë trajtimin e lehonave të papunësuar, trajtimin e duhur të pensionistëve, të viktimave të dhunës seksuale të luftës së fundit si dhe të personave me aftësi të kufizuara.

Duke folur për të arriturat e vitit në fushën sociale, ministri ka thënë se është rritur asistencë sociale për 20 për qind si dhe është rritur pagesa mujore për strehim familjar për fëmijë pa përkujdesje si dhe për fëmijët me aftësi të kufizuara. Sipas tij, të arritura janë shënuar edhe në fushën e punës si dhe sigurisë dhe shëndetit në punë. "Gjatë vitit që po lëmë pas janë trajtuar mbi 11 mijë punëkërkes, prej tyre 6 659 në punësim dhe 4 957 në aftësim profesional. Është kompletuar ligji për siguri dhe shëndet në punë me akte nënligjore, në të cilat janë transpozuar 16 direktiva. Janë realizuar tri fushata vetëdijësuese për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, ndërkaq inspektorati i punës ka realizuar mbi 8 512 inspektime", ka thënë ministri.



Ai përmendi edhe planin operativ në sektorin e ndërtimtarisë i cili ka nisur nga tetori i vitit 2018 ku janë shtuar inspektimet dhe u është pezulluar puna disa vendpunishteve që nuk i kanë përbushur masat e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Në fushën e pensioneve, Reçica evidentoi si të arritura funksionalizimin e skemave pensionale: pensioni invalidor i punës, pensioni familjar, pensioni për

paraplegjikë dhe tetraplegjikë, është funksionalizuar komisioni mjekësor për vlerësimin e shkallës së invalidëve të luftës, si dhe ka nisur kompensimi i viktimave të dhunës seksuale të luftës së fundit në Kosovë. Ai ka thënë se MPMS-ja në vitin 2018 ka përbushur 100 për qind të masave dhe aktiviteteve të parapara në dokumentet për agjendën evropiane. Për vitin 2019, objektivat dhe prioritetet

kryesore sipas ministrit Reçica janë: finalizimi i reformave të nisura në vitin 2018, zgjerimi i shërbimeve të punësimin dhe masave aktive të tregut të punës, ngritja e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, parandalimi i rasteve të lëndimeve në punë, luftimi i informalitetit në marrëdhënien e punës, fuqizimi i rolit të inspektoratit të punës dhe marrëveshjet për sigurime sociale.

Edhe 'Trainkos'-i i bashkëngjitet Valës



PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER) - I tërë personeli prej 240 punonjësve të kompanisë publike "Trainkos" që nga janari i vitit të ardhshëm do të kenë numra të Valës sikurse pjesa më e madhe e institucioneve publike e shtetërore dhe ndërmarrjeve të shumta private. Kjo u mundësua të enjten pas nënshkrimit të marrëveshjes nga ana e zëvendëskryeshefit të Telekomit të Kosovës, Zeqir

Kiqina dhe kryeshefit ekzekutiv të ndërmarrjes publike "Trainkos", Gelor Shala, marrëveshje kjo e cila automatikisht të gjithë stafin e kësaj ndërmarrje e kalon në operatorin publik Vala. "Fakti që deri më sot personeli i kësaj ndërmarrje ka përdorur numrat e një operatori tjetër konkurrent dhe tash e tutje do t'i bashkëngjiten Valës tregon më së miri se shërbimet dhe atraktiviteti i produkteve

tona janë gjithnjë e më tepër duke u mirëpritur nga shumë institucione, ndërmarrje dhe biznese private dhe nga konsumatorë të rinj", ka thënë Kiqina. Nga ana e tij, kryeshefi ekzekutiv i "Trainkos"-it ka bërë me dije se stafi që ai udhëheq do të ketë lehtësime dhe përparësi të tjera të komunikimit, që është një ndihmesë e madhe teknike për mbarëvajtjen e punëve operative.

Bukëpjekësit me peticion i drejtohen Qeverisë

Prishtinë, 27 dhjetor (ER) - Problemet e furrave të bukës, shitja e produkteve nën kosto të ulët, ulja e çmimit të energjisë elektrike prej 50 përqindësh, kamata prej 5 përqindësh për para të imëta nga bankat komerciale, të rritet kontrolli i kualitetit të bukës, të luftohet tregu joformal ku bëhet prodhimi i produkteve pa licencë, të krijohet një rregullator për përcaktimin e çmimit të bukës, mungesa e punëtorëve profesional dhe peticioni i organizuar, ishin temat e konferencës së organizuar nga Oda e Afarizmit të Kosovës me bizneset e këtij sektori.

OAK-u pas konsultimeve me këtë sektor ka mbledhur deri me tani

dhjetëra nënshkrime nga furrat, duke bërë një peticion të cilin do ta dërgojë në Qeveri, në Ministrinë e Financave, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Rreze Cana, zyrtare në Odën e Afarizmit të Kosovës, ka prezantuar problemet e identifikuara dhe pikat të cilat kanë nxjerrë për zgjidhjen e këtyre problemeve që furrat po hasin gjatë punës së tyre dhe po iu shkaktohen dëme. Cana ka theksuar se duhet të krijohet një rregullator për përcaktimin e çmimeve të produkteve esenciale pasi, për shkak të rritjes së çmimit të miellit, furrat janë detyruar ta rrisin çmimin e bukës.



Hamza: 2018-a, vit i suksesshëm për Ministrinë e Financave

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 DHJETOR - "Duke iu falënderuar punës së madhe të stafit të Ministrisë së Financave, ne si ministri po e përmbylлим vitin me sukses. Falë angazhimit të madh të stafit të MF-së dhe një bashkëpunimi të shëndoshë me donatorët, ne kemi arritur të nënshkruajmë 25 marrëveshje financiare, ku 17 prej tyre janë marrëveshje grant në vlerë prej 181 milionë eurosh", ka bërë me dije të enjten ministri i Financave, Bedri Hamza, në konferencën e fundit për këtë vit.

Hamza ka theksuar se gjatë vitit 2018 Ministria e Financave ka performuar lart në fushën legjislative, ku janë proceduar në Kuvendin e Kosovës 14 ligje. Ndërsa sa iu përket reformave fiskale, ministri Hamza ka bërë me dije se gjatë vitit 2018 është bërë reforma më e madhe ekonomike që ka ndodhur ndonjëherë në vend, duke filluar nga lirimet nga tatimi doganor për lëndën e parë, gjysmëprodukti, linjat e prodhimit,

pjesët rezervë dhe pajisjet e IT-së si dhe lirimi nga tatimi i akcizës për lëndët ndihmëse në procesin e prodhimit.

Ministri Hamza ka bërë me dije se performanca ekonomike mbetet solide, me tendencë përmirësimi. Sipas ministrit Hamza, Kosova do të ketë rritje prej 4.3 përqindësh, ku investimet private dhe publike, si dhe eksportet, janë kontribuuesit kryesorë të kësaj rritje. Ai ka veçuar performancën e lartë të Ministrisë së Financave për kryerjen e obligimeve ligjore dhe përgjegjësi që ka për menaxhimin e financave publike ku, sipas ministrit Hamza, sot MF-ja ka arritur t'i kryej të gjitha transferimet sociale dhe transferimet e pagave si në nivelin qendror, po ashtu edhe në atë komunal. Ndërkaq sa iu përket të hyrave buxhetore, ministri Hamza ka bërë me dije se ka pasur rritje të të hyrave buxhetore prej 6 përqindësh, ku të hyrat tatimore kanë qenë 1.5 miliard euro, shumë e cila pritet të rritet për disa milionë euro deri në fund të vitit, respektivisht deri më 31 dhjetor të këtij



viti. Me këtë rast, ministri Hamza ka thënë se sa i përket ndikimit në mospërmbylljen e planit të të hyrave, ka ndikuar performanca e dobët komunave për të hyrat, ku me këtë rast ministri Hamza ka bërë thirrje për angazhim dhe përkushtim më të madh nga komunat sa iu përket

të hyrave komunale. Kurse sa iu përket shpenzimeve buxhetore, vlen të theksohet se një ndër sukseset më të mëdha në këtë vit është që për herë të parë që nga viti 2013, investimet kapitale kanë kaluar shumën mbi 500 milionë euro. "Ndërsa bilanci bankar është në një nivel shumë

të mirë dhe presim që këtë vit të jetë 385 milionë euro që, në krahasim me vitin e kaluar ishte 358 milionë euro. Ndërsa deficitin buxhetor ka qenë i projektuar për 2 për qind dhe, sipas rezultateve, shihet se deficitin primar është 0.9 për qind", ka thënë ministri Hamza.

Beqaj: Ministria e Inovacionit ka arritur që Kosovën ta bëjë pjesë të agjendës digjitale të KE-së

PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER) - Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka mbajtur konferencën e fundit me media, në të cilën ka prezantuar të arriturat e kësaj ministrie gjatë vitit 2018 si dhe ka folur edhe për synimet dhe projektet për vitin 2019. Duke folur për aktivitetet e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë gjatë vitit që po lëmë pas, ministri Beqaj ka thënë se, edhe pse ministri e re, Ministria e Inovacionit ka arritur që Kosovën ta bëjë pjesë të Agjendës Digjitale të Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor. "Në vitin 2018 MIN ka ndarë afër pesë milionë euro nga të cilat janë financuar mbi 53 OJQ, 160 start-up, si dhe në bashkëpunim me CETEP-in me Ministrinë Federale të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit të Gjermanisë, përmes GIZ-it, kemi përkrahur shumë ndërmarrje për eksport", ka thënë Beqaj.

Ndër të arriturat, Beqaj ka përmendur edhe transformimin e Kampit Ushtarak të KFOR-it gjerman në Prizren në Park për Inovacion dhe Trajnime, theme-



limin e dy qendrave të Inovacionit në Prishtinë dhe në

Ferizaj. Si suksese të punës së Ministrisë së Inovacionit dhe

Ndërmarrësisë gjatë vitit 2018, ministri Beqaj ka përmendur

edhe futjen e Kosovës si pjesë të Agjendës Digjitale të Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor, hapjen e të dhënave (open-data) nga Institucionet e Republikës së Kosovës, organizimin e Konferencës Ndërkombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrje "DIGITALKS", mbështetjen financiare për promovimin e bizneseve kosovare në panaire ndërkombëtare, bashkorganizimin dhe financimin e konferencave vendore.

Ministri Beqaj para gazetarëve ka prezantuar edhe projektet e reja të cilat pritet të realizohen në vitin 2019. Beqaj ka thënë se buxheti i ministrisë për vitin 2019 do të jetë 12 milionë euro, vlerë e cila do të rritet deri në 20 milionë euro me projekte të bashkëfinancimit me organizata ndërkombëtare.

Ministri Besim Beqaj i ka falënderuar të gjitha mediat dhe shoqërinë civile për bashkëpunimin e treguar gjatë vitit 2018, duke theksuar se vazhdimi i këtij bashkëpunimi është shumë i rëndësishëm për ministrinë që drejton dhe për qytetarët e Kosovës.

Komuna e Kaçanikut gjatë vitit 2018 subvencionojë 405 fermerë

KAÇANIK, 27 DHJETOR (ER) - Komuna e Kaçanikut gjatë vitit 2018 ka përkrahur me subvencione 405 fermerë të kësaj komune. Është bërë me dije se në kuadër të projekteve të planifikuara për tremujorin e fundit janë realizuar edhe disa projekte që kishin për qëllim përkrahjen e fermerëve me pajisje të ndryshme në zhvillim të veprimtarive të tyre bujqësore. Kryetari i Kaçanikut, Besim Ilazi, së bashku me drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Fatmir Loku, kanë monitoruar procesin e shpërndarjes së pajisjeve bujqësore. Me këtë rast, ai ka thënë se kjo komunë ka vazhduar traditën e përkrahjes së fermerëve, me qëllim që të kenë mundësi teknike për realizimin e veprimtarive bujqësore. Ilazi ka theksuar se edhe gjatë vitit 2019 do të vazhdohet përkrahje e bujqve, të

cilët kryesisht merren dhe krijojnë të ardhura familjare nga bujqësia. Drejtoria e Bujqësisë në Kaçanik ka realizuar projektin për mbështetje të fermerëve kultivues të grurit, ku përfitues kanë qenë 95 fermerë, ndërsa vlera e projektit është 12 990 euro, projektin për mbështetje të fermerëve blegtorë për blerje të makinave mjelëse, përfitues 56 fermerë, ndërsa vlera e projektit është 8 960 euro. Gjithashtu, është realizuar edhe projekti për mbështetje të fermerëve për blerje të mekanizmit bujqësor. Po ashtu, Komuna e Kaçanikut gjatë vitit 2018 ka përkrahur bletarët me koshere të bletëve, ku përfitues kanë qenë 94 bletarë, ndërsa janë përkrahur edhe 70 fermerë me serra në kuadër të projektit për mbështetje të fermerëve me serra që ka kushtuar 27 890 euro.



Gjakova me dy aktivitete të rëndësishme për fundvit

GJAKOVË, 27 DHJETOR (ER) - Komuna e Gjakovës është duke e përmbyllur vitin 2018 me dy aktivitete shumë të rëndësishme sa i përket jetës kulturore e sportive. Koncerti i Ansambllit të Qytetit dhe Shpallja e Sportistit të Vitit janë dy aktivitetet që do ta përmbyllin një vit të suksesshëm për Gjakovën. Në një konferencë për

medie, drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Saranda Hyseni, ka thënë se kjo drejtori në bashkëpunim me punëtorët më të mirë kulturorë e sportivë kanë përgatitur programet më të mira të mundshme për këto dy aktivitete. Ajo ka ftuar të gjithë qytetarët që të jenë pjesë e këtyre aktiviteteve si dhe të gjitha ngjarjeve të tjera që komuna po orga-

nizon me rastin e festave të fundvitit.

Koncerti festiv i ansambllit të qytetit mbahet sot (e premte), më 28 dhjetor, ndërsa ceremonia e shpalljes së sportistit të vitit mbahet një ditë më vonë, më 29 dhjetor. Të dy aktivitetet mbahet në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi" dhe fillojnë prej orës 19:00.



Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë bëhet me autoambulancë të re

PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se Qendra e Mjekësisë Urgjente në kryeqytet është pajisur me një autoambulancë të re. Kjo komunë ka theksuar se

do ta vazhdojë ngritjen e kapaciteteve në shërbimin parësor shëndetësor në kryeqytet. "Vazhdon investimi në ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve në shëndetin

parësor në kryeqytet. Nga sot Qendra e Mjekësisë Urgjente është pajisur me një autoambulancë të re", ka njoftuar Komuna e Prishtinës e cila drejtohet nga Shpend Ahmeti.

Nis ndërtimi i shtëpisë për personat me aftësi të kufizuara mendore

Prizren, 27 dhjetor (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka marrë pjesë në vënien e gurthemelit për ndërtimin e shtëpisë së komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore dhe ngecje në zhvillim. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka thënë se kjo shtëpi do të ofrojë shërbim të ri psikosocial sipas standardeve bashkëkohore. "Sot vëmë gurthemelin e shtëpisë së komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore dhe ngecje në zhvillim. Me këtë ndërtesë Komuna e Prizrenit

do të ofrojë një shërbim të ri psikosocial me standarde bashkëkohore. Na priftë e mbara!", ka thënë Haskuka. Kjo shtëpi do të ofrojë shërbim për 24 orë ndaj këtyre personave, në veçanti për ata të cilët nuk kanë përkujdesje familjare. Realizimi i këtij projekti është mundësuar falë bashkëpunimit në mes të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Prizrenit dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa punimet pritet të përfundojnë në verën e vitit 2019.



Narkoza e vizave - mit apo realitet (7)



Shkruan: Agron HOTI

Kritere kalkulative

Për dallim prej shteteve të tjera që sot gëzojnë liberalizimin e vizave, BE-ja padrejtësisht i vuri Kosovës edhe kriterin e demarkacionit me Malin e Zi, që s'kishte ndodhur me asnjë shtet tjetër të rajonit. Nëse kriteret duhet të jenë të njëjta për të gjithë, pse për Kosovën u dyfishuan?! Pse u shtua demarkacioni i cili ishte dërmues për zhvillimet në Kosovë duke polarizuar shoqërinë kosovare deri në përmasa të shpërthimit të luftës qytetare?! Dhe përderisa nuk ratifikohet demarkacioni na thuhej "ju lutem ratifikojeni sa më shpejt atë në mënyrë që të ndodhë liberalizimi" dhe, kur ratifikimi ndodhi, tani na thuhet se s'ka konsensus politik.

Kosova edhe sa u përket procedurave të brendshme të BE-së, pati edhe një hap procedural shtesë, të cilin nuk e kishin të gjitha vendet e rajonit. Sipas Traktatit të Lisbonës, i cili kishte hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2009, roli i Parlamentit Evropian që fuqizuar në disa procedura legjislative. Përderisa opinioni pozitiv i Parlamentit Evropian për heqje të vizave për Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë ka qenë jo-obligativ, kjo me Traktatin e Lisbonës u bë obligative. Pra, Kosova në të gjitha drejtimet e mundshme është përballur dhe po përballet me rritje të kriterëve, procedurave dhe vështirësive.

Ajo çfarë është shqetësuese është fakti se BE është shpesh, nëse jo gjithmonë, tepër kalkulative politikisht. Në kohën kur më 1 prill 2009 Shqipëria dhe Kroacia qenë anëtarësuar në NATO, kishte një frikë të paparë brenda BE-së, kryesisht nga aleatë të Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, se mos po prishet balanca i fuqisë në Ballkanin Perëndimor. Dhe për të balancuar gjërat BE menjëherë në dhjetor të vitit 2009 me shpejtësi u hoqi vizat këtyre tri shteteve edhe pse këto të fundit linin, dhe ende lënë shumë për të dëshiruar, pikërisht sa i përket sektorit të Sundimit të Ligjit. Madje Serbisë ju hoqën vizat pa e plotësuar kriterin më të rëndë që ishte dorëzimi i kriminelëve të luftës në Tribunalin e Hagës, diçka që Kosova vazhdimisht e ka bërë në

mënyrë vullnetare pa asnjë problem.

BE ishte politikisht kalkulative edhe kur pranoi në gjirin e vet Rumaninë dhe Bullgarinë në vitin 2007, shtete këto që edhe sot nuk janë anëtare të Schengenit, pikërisht për faktin se nuk kanë treguar sukses në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Pra, dihet se qëllimi i vërtetë i pranimi të këtyre dy shteteve ishte rreziku i rrëshqitjes së këtyre dy vendeve nën ombrellën ruse. Pra, anëtarësimi ndodhi si kundërpërgjigje ndaj progresit që Rusia po shënonte me Putinin në krye. BE ishte politikisht kalkulative edhe kur pranoi Greqinë në Eurozonë, kur më vonë flitej shumë për manipulimin e të dhënave nga ky shtet, aspekt që u konfirmua me krizën financiare greke së cilës nuk po i shihet fundi as sot.

Gjeopolitikë për viza?

Nëse BE-ja ka dashur të kalkulojë gjeopolitikisht kur i hoqi vizat Ukrainës, Gjeorgjisë dhe Moldavisë, vende këto me pjesë territori të pushtuara nga Rusia, pra me siguri të brendshme dhe të jashtme pothuaj zero, atëherë pse nuk kalkuloi njëjtë edhe me Kosovën, kur dihet qartë se Pavarësia e Kosovës, ligjërisht e konfirmuar dhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, kontribuoi dukshëm për paqen dhe stabilitetin në rajon, kurse NATO, për dallim prej Ukrainës, Gjeorgjisë e Moldavisë garanton sigurinë e brendshme dhe të jashtme të Kosovës, diçka që nuk e kanë këto shtete.

Se sa është jofunksionale Ukraina, dëshmojnë përpjekjet e pjesës lindore të saj për të organizuar zgjedhje, diçka që është duke e kundërshtuar BE-ja, e duke e mbështetur fuqishëm Rusia. E Ukraina së fundi nxjerr edhe ligj të pakuptueshëm për luftën kundër Rusisë, ndërkohë që gëzon liberalizimin e vizave. Pra, si ka mundësi që Ukraina të gëzojë liberalizimin e vizave, kur ekspansioni rus në këtë shtet pothuaj ka paralizuar çdo gjë?! Pastaj, vizat iu hoqën Kolumbisë që nuk është fare në kontinentin e Evropës, një shtet që qysh prej pas Luftës së Dytë Botërore e deri më sot vetë-terrorizohet nga korrupsioni dhe krimi i organizuar, kryesisht nga kartelet e drogës.

Si ka mundësi që mos t'u hiqen vizat qytetarëve të Kosovës, kur Kosova është vendi më proevropian në Evropë (edhe më pro-evropian se vet vendet e BE-së), kur Kosova feston 9 majin, Ditën e Evropës, e asnjë vend i BE-së nuk e feston, kur Kosova ka një popullsi tërësisht të orientuar kah BE më shumë se sa çdo vend tjetër në rajon, kur Kosova ka një diasporë të fuqishme që

më të lartën në Evropë (sipas Bankës Botërore)?

Absolutisht që nuk mund ta themi, sepse Kosova, edhe pse ka progres në disa segmente të caktuara, është larg mesatares së nivelit të qeverisjes që mbretëron në BE. Poenta këtu nuk është krahasimi i Kosovës me BE-në, sepse jemi ende larg atyre standardeve, por të qenurit kalkulativ duke kërkuar vetëm pika të dobëta nuk është ndonjë masë incentive për të ecur përpara.

Nevoja për vetëkritikë

Kosova vazhdimisht kritikohet nëpër Raporte të Progresit të BE-së për drejtësi të dështuar. Mirëpo, përse as edhe një herë të vetme nuk vetë-reflektoi nëpër këto Raporte të rregullta të Progresit për Kosovën për efektet e vërteta të misionit më të madh të saj në Kosovë, EULEX, që kishte dhe ka për synim fuqizimin e sundimit të ligjit, përfshirë përmirësimin e sistemit të drejtësisë sipas praktikave më të mira dhe standardeve evropiane. E dihet që Kosova këtij misioni i kishte hapur dyert menjëherë pas shpalljes së pavarësisë dhe se qytetarët e Kosovës e meritojnë të informohen qartë me një vetëkritikë të EULEX-it mbi të arriturat/dështimet e këtij misioni i cili ende vazhdon të operojë në Kosovë.

Pyetja që duhet shtruar është: kush e pengoi EULEX-in që të fuqizojë Sundimin e Ligjit në Kosovë, kur dihet se disponimi dhe pritjet qytetare ishin shumë të mëdha?! Si ka mundësi që Kosova të merr donacione të BE-së më së shumti për kokë banori në Ballkan, të ketë misionin më të madh të BE-së për Sundim të Ligjit dhe të ketë problemet më të mëdha me Sundimin e Ligjit?! Kush e pengoi BE-në që të vepronte, kur dihet se i kishte duart e lira

për të arrestuar kë të donte dhe kur të donte duke pasur edhe KFOR-in në ndihmë për çfarëdo lëvizje kundërshtuese që mund të ndodhte?!

Në qoftë se EULEX-i ka kalkuluar politikisht, pra nuk ka vepruar për hir të stabilitetit politik dhe proceseve të ndërlikuara politike, atëherë për këtë s'mund të jetë fajtorë Kosova. Qytetarët e Kosovës kanë prituri drejtësi nga EULEX-i e jo kalkulime politike. Pra, vetë fakti që EULEX-i kalkulonte dhe kalkulonte politikisht dëshmon për paafhtësinë e këtij misioni në forcimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë, prandaj përgjegjësia duhet ndarë dhe secili të merr pjesën e vet, jo të hidhet vrerë vetëm në drejtim të institucioneve të Kosovës edhe pse këto të fundit nuk është që tentuan të dëshmojnë ndonjë performancë kredibile.

Nuk do mend që sistemi i drejtësisë në Kosovë ka probleme. E problemet edhe më shumë shtohen kur Kosova, për dallim prej vendeve të rajonit, asnjëherë nuk pati mundësi që të shtrijë 100% Sundimin e Ligjit në veri të Kosovës, pra në tërë territorin e njohur ndërkombëtarisht. Dhe BE asnjëherë nuk u tregua e vendosur që të bënte presion ndaj Serbisë që të mos e pengonte Kosovën në shtrirjen e plotë së sovranitetit të saj.

Ndërkaq, kur qytetarët shohin se bashkëvendësit e tyre serbë nuk i paguajnë Kosovës as taksa e fatura, atëherë besimi i tyre në institucionet e Kosovës, përfshirë sistemin e drejtësisë bie në nivelet më të ulëta të mundshme dhe situata bëhet edhe më e rëndë nga pamundësia e Kosovës që të bëjë më shumë në këtë drejtim si rezultat i ndërhyrjeve të Serbisë e bën të cënueshme ndaj pritjeve të qytetarëve çdo Qeveri të Kosovës.

(Vijon)



Në Gjermani arrestohen të dyshuarit për planifikim sulmesh terroriste

Berlin, 27 dhjetor - Katër persona u arrestuan në Gjermani me dyshimin e planifikimit të një sulmi terrorist, të cilët mohuan përfshirjen e tyre, theksoi zëd-

hënësi i prokurorisë në Karlsruhe. Tre burrat dhe një grua po hetohen, pasi dyshohen se po përgatisnin një akt të rëndë dhune,

ku gjatë kontrollit u konfiskua një armë tip "Kalashnikov", në Plankstadt, pranë Heidelbergut. Një grua 39-vjeçare dhe dy burra të moshës 33 dhe 49 vjeç u

arrestuan pasi policia kontrolloi pronat në Mannheim në rajonin Rhine-Neckar, ndërsa një 53-vjeçar u arrestua në Aeroportin e Frankfurtit.



Trumpi dhe demokratët bëhen gati për vitin 2019

Në ShBA, 2018-a ishte vit ndryshimesh në politikën amerikane pasi demokratët e opozitës rimorën kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve në zgjedhjet e Kongresit në nëntor dhe kjo mund të ketë ndikim gjatë dy vjetëve të ardhshëm të mandatit të presidentit Donald Trump

WASHINGTON, 27 DHJETOR - Viti 2018 ishte vit ndryshimesh në politikën amerikane. Demokratët e opozitës rimorën kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve në zgjedhjet e Kongresit në nëntor dhe kjo mund të ketë ndikim gjatë dy vjetëve të ardhshëm të mandatit të presidentit Donald Trump. "Falë jush, nesër do të jetë një ditë e re në Amerikë!", tha udhëheqësja e demokratëve në Kongres, Nancy Pelosi, pas rezultateve të zgjedhjeve të Kongresit që u rikthyen shumicën demokratëve në Dhomën e Përfaqësuesve. Demokratët e siguruan fitoren me një kundërshtim të fortë ndaj presidentit Donald Trump, që u shpreh përmes pjesëmarrjes së lartë të grave dhe votuesve progresistë, në mbështetje të kandidatëve si demokracia nga Masaçusets, Ayanna Pressley. "Ne konfirmuam se nuk do të

lejojmë që kjo të jetë periudha më e errët në histori. Fati ynë do të përcaktohet nga shpresat, jo nga frika", tha ajo. Presidenti Trump tani përballet me perspektivën e një programi legjislativ dhe hetime të shumta të ndërmarra nga demokratët e Dhomës së Përfaqësuesve. Por Trumpi vazhdon të mbetet sfidues. "Nuk kanë gjetur asgjë. Zero. E dini pse? Sepse nuk ka asgjë. Ata mund ta bëjnë këtë lojë, por ne mund të luajmë më mirë", është shprehur ai. "Presidenti Trump dhe udhëheqësit demokratë kanë filluar përplasjet për financimin e murit në kufi, një parathënie e betejave të pritshme politike", thotë analisti John Fortier. "Demokratët me siguri do ta përdorin shumicën për t'i nxjerrë në pah mosmarrëveshjet me Donald Trumpin dhe për ta hetuar administratën e presidentit Trump. Dhe ky do të jetë një vit transicioni deri në



2020-n", thotë ai. "Pa një kontroll të plotë të republikanëve në Kongres, Trumpit mund t'i duhet të arrijë disa marrëveshje me demokratët", thotë Jim Kessler. "Nuk kemi parë ende që Donald Trumpi ta ketë aftësinë të bashkëpunojë me demokratët për të arritur ndonjë marrëveshje në dy vjetët e para. Kështu që, ai nuk ka pasur sukses në këtë drejtim dhe do të shohim nëse do të jetë e mundur në

vazhdim", tha ai. Por, presidentit i duhet të përballet edhe me hetimin për Rusinë, që në muajt e ardhshëm mund të përfundojë. "Është një vit vendimtar për presidentin Trump. Atij do t'i duhet të përballet me përfundimet e hetimit të Muellerit. Dhe do të jetë një vit i vështirë për të", thotë analisti politik Tom DeFrank. Trupi gjithnjë e më shumë do të përqendrohet te zgjedhjet e

ardhshme presidenciale, ashtu si edhe shumë demokratë që shpresojnë ta mundin atë, thotë Guian McKee. "E vërteta është se fushata e vitit 2020 ka filluar. Është disi për të ardhur keq por, ky fakt, përcakton gjithçka tani e tutje", tha ai. Rrjedha e ngjarjeve në vitin 2019 do të jetë një faktor i rëndësishëm për të përcaktuar nëse Donald Trumpi do të jetë president për një apo dy mandate.

Ushtria gjermane mund të rekrutojë njerëz nga BE-ja

BERLIN, 27 DHJETOR - Shtatë vjet pasi Gjermania ka braktisur kërkesat e detyrueshme ndaj banorëve të saj për t'iu bashkuar ushtrisë, Inspektori i Përgjithshëm i Ushtrisë së këtij shteti, Eberhard Zorn, ka thënë se është duke u shqyrtuar mundësia e punësimit të qytetarëve evropianë në pozitat e ekspertëve. Zorn ka thënë se forcat gjermane "duhet të shikojnë në të gjitha drejtimet në kohën kur ka mungesë të personelit të kualifikuar", duke përmendur doktorët dhe specialistët e teknologjisë informative.



Forcat e Armatosura të Gjermanisë ka vite që janë përballur me mungesë të inves-

timeve. Prandaj ky shtet synon ta rrisë personelin ushtarak me 21 000 persona të tjerë deri më 2025.

Përveç të tjerash, autoritetet kanë premtuar edhe rritjen e buxhetit për mbrojtje nga 1.2 për qind në 1.5 për qind të bruto-prodhimit të brendshëm (GDP) deri më 2024. Ministria gjermane e Mbrojtjes, Ursula von der Leyen ka thënë se Ushtria gjermane i janë shtuar 6 500 trupa për dy vjet, derisa në shtatë vjetët e ardhshme pritet që Ushtria gjermane të ketë 203 000 trupa. Ajo ka thënë se 12 për qind e personelit ushtarak tani përbëhet nga gratë dhe se vetëm këtë vit, një nga tre personat që kanë synuar të marrin pozita në ushtri ka qenë grua.

Ndërkohë gjenerali Zorn ka thënë se ushtria duhet "të punojë më shumë për të siguruar një generatë të re", ndonëse qytetarët e Bashkimit Evropian mund të jenë pjesë e ushtrisë vetëm në pozita të veçanta. Sipas ligjeve pas Luftës së Dytë Botërore, pjesëtarët e Ushtrisë së Gjermanisë duhet të jenë gjermanë. Komisionari parlamentar për forca të armatosura, Hans-Peter Bartels, ka thënë se rekrutimi i qytetarëve të BE-së "është pothuajse gjë normale" pasi shumë ushtarë veçse kanë dy shtetësi apo histori të imigrimit.

Rritet alarmi për shpërthimin e vullkanit në Indonezi

XHAKARTË, 27 DHJETOR - Të enjten autoritetet në Indonezi e rritën nivelin e alarmit rreth mundësisë së shpërthimit sërish të vullkanit Anak Krakatoa, që u bë shkak për një cunami vdekjeprurës.

Zona e rrezikuar rreth vullkanit u zgjerua nga dy në pesë kilometra dhe banorët u paralajmëruan të qëndrojnë larg bregdetit. Cunami i së shtunës shkaktoi vdekjen e më shumë se 400 per-

sonave dhe zhvendosjen e rreth 22 mijë të tjerëve. Banorët e zhvendosur po përpiqen të përballojnë akthin e një cunami tjetër. Shirat e rrëmbyeshëm të ditës së

enjte u bënë pengesë për operacionet e kërkimit të më shumë se 150 personave, të cilët rezultojnë ende të humbur, si dhe kanë rritur shqetësimin për përmbajtje të tjera.





BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



E rrallë

Gruas shtatzënë i hiqet tumori 15 kilogramë pas lindjes

Mjekët italianë të spitalit San Giovanni di Dio dhe Ruggi d'Aragona në Salerno kanë bërë të mundur që një grua 38-vjeçare ta sillte në jetë fëmijën e saj. Gruaja arriti ta çojë shtatzëninë deri në fund pavarësisht se kishte një tumor prej 15 kilogramësh në bark. Ekipi i mjekëve këtë fillimjavë fillim-



isht solli në jetë fëmijën, me peshë pak më shumë se tre kilogramë dhe 50 centimetra të gjatë. Më tej ata hoqën masën tumorale, duke i bërë gruas disa transfuzione gjaku.


FOTO E DITES

Një person në Filipine shihet duke i mbushur fishekzjarrët me barut për festimet e Vitit të Ri. /AFP/

E jashtëzakonshme

Zbulohen gdhendje guri të fshehura prej 600 vjetësh

Gdhendjet e gurit që kanë mbetur të fshehura për 600 vjet janë zbuluar në varrin e një peshkopi mesjetar në Skoci. Figura të shenjta u zbuluan në anën e një muri, ndërsa gërmuesit kryen një inspektim rutinë.

**BARSOLETA E DITËS**

Endriti: Më fal, a ke shkrepëse, bre?
Blendi: Po, more!
Endriti: Mos ke edhe një cigare, bre?
Blendi: Edhe cigare kam. Po, prit, mos dil, ja merre edhe xhakëtën time se ish ftoftë.

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Në ora 16:00

“THE GRINCH” 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

“THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS” 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

“MORTAL ENGINES” 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

“HUNTER KILLER”,

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

**DASHI**

Duhet të filloni të merni vendime që duhet të pranohen nga të gjithë. Sot është një ditë që do t'ju tregojë se jeni lider në fushën tuaj.

**DEMI**

Jeni të preokupuar shumë me çështjet e punës dhe nuk po u kushtoni rëndësi vlerave afektive në jetën tuaj.

**BINJAKËT**

Edhe pse mënyra juaj e komunikimit nuk do të pëlqehet nga të gjithë, vazhdoni të jeni korrekte dhe e sinqertë në ato që thoni.

**GAFORRJA**

Të jepni ultimatum sot mund të mos jetë zgjidhja më e mirë për ta vendosur autoritetin tuaj.

**LUANI**

Në të ardhmen partneri do t'ju fajësojë për një vendim që nuk e morët në kohën e duhur.

**VIRGJËRISHA**

Nuk është e nevojshme që të tjerët t'ju tregojnë rrugën sot. Jeni në gjendje të vendosni vetë edhe duke qenë nën presion.

**PESHORJA**

Të jeni krenar sot do të sjellë pasoja në pozicionin tuaj të punës dhe në shoqëri. Mbase duhet të pranoni që edhe ju gaboni.

**AKREPI**

Mos mendoni sot se si të hakmerreni ndaj një rivalit tuaj. Lërvani çdo gjë në dorë kohës sepse hakmarrja është një pjatë që serviret e ftohtë.

**SHIGJETARI**

Sot do të vendoseni përballë situatave të ndryshme që duhet t'i jepni zgjidhje të shpejtë. Do të tregoheni mjaft fleksibël.

**BRICJAPI**

Po vini në vështirësi këdo që ju qëndron pranë dhe do të vijë një moment që durimi do të soset. Kujdes me sjelljet sot.

**UJORI**

Proveni t'i ngjisni një nga një shkallët e suksesit. Mos tentoni të keni të gjithë tortën sot, edhe një pjesë do t'ju shijojë po njësoj.

**PESHQIT**


Në të shkuarën tuaj keni realizuar atë që keni dashur. Filloni të keni të njëjtin shpirt iniciative edhe sot.

A po e konfirmon martesën Miley Cyrus?



Miley Cyrus dhe Liam Hemsworth duket se tashmë mund të jenë duke shijuar muajin e mjaltit. Këngëtarja ka postuar disa fotografi romantike, bardh e zi, me Hemsworth, vetëm dy

ditë pasi u përhap lajmi se çifti kishte kurorëzuar dashurinë e tyre. "Dhjetë vjet më vonë", kishte shkruar ajo në njëren nga fotografitë ku ajo shihet teksa përqafton Hemsworthin.



Prishet miqësia në mes të Demit dhe Nickit

Dy fytyrat e njohura, Demi Lovato dhe Nick Jonas, dikur ishin shumë miq të mirë por, siç duket, që nga dasma e Jonas me aktoren Priyanka Chopra kjo miqësi është distancuar, pasi

Jonas nuk e kishte ftuar në dasmë mikeshën Lovato e cila sapo kishte dalë nga qendra e rehabilitimit për shkak të mbidozës. Ende nuk dihet nëse Priyanka është shkaktare e kësaj distance.

Lidhja e Jamie Foxxit dhe Katie Holmesit po bëhet më serioze



Prej kur 40-vjeçarja Katie Holmes dhe 51-vjeçari Jamie Foxx ishin parë së bashku duke vallëzuar në vitin 2013 në Hamptons, çifti kanë bërë përpjekje të mëdha për ta mbajtur lidhjen e tyre, larg syrit të publikut dhe mediave. Por, së fundmi, çifti


duket se ka vendosur të mos e mbajë kaq sekrete romancën katërvjeçare e gjysmë. Së fundmi, për ditëlindjen e 40 të Holmesit, më 18 dhjetor, çifti janë parë që kanë dalë bashkë me nënën e Holmes, Kathleen, në një vend të njohur turistik në Nju Jork.

Selena Gomezi në mbështetje të shoqes së saj



Selena Gomezi dhe Taylor Swifti njihen për miqësinë e tyre të fortë, shumë herë ka ndodhur që në rrjetet sociale të bëjnë dedikime për njëra-tjetrën. Sërish njësoi veproi Selena duke e mbështetur shoqen për turneun e Swiftit që

pritet t'ia fillojë së shpejti. Ndërsa forma që e ka mbështetur është shumë e lezetshme. Ajo për shëtitjen e saj ka veshur një bluzë, ku tregon për turneun e Swiftit. Gomezi tash e një kohë nuk ka qenë e pranishme në media për shkak të rehabilitimit.



Sadik KRASNIQI

AKTORI

*Sa herë lindur
e sa herë vdekur
herë mbret
herë duarthatë.*

*I fortë si shkëmb
kala
kështjellë
fortifikatë*

*Ndrit si diell
si yll është kozmos
është vullkan që shpërthen
kur e liga zë vend.*

*Është si fëmijë
i virgjër
me butësi
e ndjesi.*

*Shpeshherë trajtuar si grimcë e vogël
letër e shkruar
e shkarravitur
djegur e shkrumbuar
gumëzhitur e hedhur në kosh
plehrash.*

*Është bardhësi
është ujë i kulluar
që rrjedh e nuk ndalet
me ngjyrën e qiellit.*

*Të gjithëve ju jep
asgjë për vete nuk merr.*

*Udhëton nëpër kohë
nga atje larg në lashtësi
ku as historia nuk mbërrin
përshkon të sotmen e shpon të ardhmen
si vetëtimë
hap shtigje për njerëzinë
gjithherë ushqehet
me të bukurën dhe mirësinë.*

‘Bretkosa’, drama psikologjik e ish-ushtarit që vuan nga PTSD dhe njerëzve që e rrethojnë

Mbrëmë në skenën e re kamertale të Teatrit AAB është dhënë premiera e shfaqjes “Bretkosa”, në regji të Burbuqe Berishës dhe me aktorët: Ilir Tafa, Donat Qosja, Basri Shala dhe Valmir Krasniqi, shkruan KultPlus.

“Bretkosa” është një dramë psikologjike, historia e të cilës zhvillohet brenda katër mureve të një dyqani të vjetër për qethje. Gjithë drama zhvillohet ditën e bajramit.

Zeka (Ilir Tafa), është një veteran i luftës i cili vuan nga Sindroma Post Traumatike (PTSD). Një njeri të cilin familja e ka lënë pasi që ka qenë i dhunshme. Në anën tjetër është vëllai i tij Toni (Donat Qosja). Ai është një burrë familjar i cili ka humbur punën dhe ngushëllimin e gjen në pijë dhe në kumar.

Vëllai i madh dëshiron ta bind të voglin që të ndryshojë, ndoshta edhe me forcë. Në mes të gjithë kësaj gjendet miku i tyre, një taksist (Basri Shala) i cili ka ikur gjatë luftës dhe e ka lënë Kosovën. Si dhe shitësi i librave (Valmir Krasniqi).

Tekstin e kësaj shfaqje e ka realizuar autori kroat Dubravko Mihanovic. Shfaqja erdhi mbrëmë në Prishtinë e adaptuar nga regjisorja Burbuqe Berisha duke iu referuar realitetit në Kosovë. Këtë e ka pohuar edhe regjisorja në një prononcim për KultPlus.

“Aktorët i kam zgjedhur duke besuar se ata do të mund ta bartin barrën të cilën e ka kjo shfaqje pasi që kjo shfaqje nuk i takon regjisores por aktorëve. Mendoj që shfaqja do të ketë jetë të gjatë pasi që korrespondon shumë mirë me shikuesin dhe është shfaqja e tyre. Së fundi kam vendosur që të merrem me individin edhe me dramën e tij brenda këtij vendi, dhe kjo ka qenë edhe një sfidë e imja”, theksoi Berisha për KultPlus.

Regjisorja Berisha thekson po ashtu që aktori Ilir Tafa ka qenë promotori i gjithë kësaj shfaqje. Drama merret me problemet e kohës së sotme që janë të njëjta ose të ngjashme edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, por edhe në Kosovë, vende këto ku edhe është realizuar kjo shfaqje. Madje, në Bosnjë aktori Ilir Tafa ka qenë pjesë e filmit të metrazhit të gjatë i cili zbërthen tekstin e skenaristit Dubravko Mihanovic. Pas dhjetë viteve, aktori Ilir Tafa është rikthyer përsëri në Kosovës për të sjellë rolin e berberit, një ish-ushtari të UÇK-së.

“Së fundi kam luajtur vetëm në Bosnjë dhe Kroaci dhe për mua kjo ka qenë edhe premierë edhe në kuptimin që jam rikthyer para publikut në Kosovë. Ka qenë e vështirë pasi që rolinuk është i lehtë. Madje mund ta konsideroj si një nga rolet më të vështira që kam luajtur deri tani. Procesi na ka marrë më shumë kohë sesa e kemi menduar kështu që tani i mbetet publikut për ta vlerësuar”, u shpreh Tafa për KultPlus. Teksti ka më shumë se 10 vite që është pjesë e repertorëve në teatrot të ndryshëm. Prandaj, sipas aktorit Donat Qosja, merita më e madhe i mbetet



skenaristit. “Skenaristi i ka gdhendur këto karaktere jashtëzakonisht mirë dhe na e ka bërë neve aktorëve punën më të lehtë”, ka theksuar ai duke shtuar se shfaqja ka momente mjaft të rëndë e të cilat gjatë provave kanë kërkuar shumë angazhim.

Kjo shfaqje parqet një gërshetim në mes të mungesës së komunikimit dhe pamundësisë për të dëgjuar mendimin e dikujt tjetër. Personazhet frymojnë dhe bashkëjetojnë me realitetin dhe janë në luftë të përhershme me veten e tyre për të bërë ndryshime. Sipas aktorit Basri Shala, shfaqja është e tillë që publiku nuk e ka idenë se çfarë do të ndodh pasi biseda është e tillë, intime

por edhe konfliktuoze.

“Jam inkuadruar shumë vonë në projekt mirëpo tema jashtëzakonisht e rëndë, e të cilën e jetojmë edhe sot, si dhe ekipi më kanë bërë që më çdo kusht të pranoj që të jem pjesë e kësaj shfaqje. Ndryshimi i vetëm në këtë shfaqje tek ne është se ajo është përditësuar me elemente tona, të Prishtinës. Përndryshe, kjo shfaqje reflekton Ballkanin, një realitet ballkanas e që vë në pah se gjenerata e re e ka më problem”, u shpreh ai për KultPlus. Reprizat e shfaqje “Bretkosa” do të jenë më 27 dhe 28 dhjetor duke filluar nga ora 20:00 në Skenën Kamertale të Teatrit AAB. /Alberina Haxhijaj-KultPlus.com/

Nga Burani te “Përbindëshi” i detit Kaspik, 5 projektet epike sovjetike

Mediat kanë përpiluar një listë të “mrekullive” të teknologjisë në Bashkimin Sovjetik që edhe sot mund të cilësohen si projekte epike.

Disa prej tyre u ruajtën si trashëgimi, të tjerë u harruan dhe disa ende veprojnë sot.


Tu-144, ‘Concord-i Sovjetik’

Një nga dy avionë komercialë të transportit supersonik – tjetri ishte Concorde – Tupolev Tu-144 u krijua më 31 dhjetor 1968, dy muaj përpara homologut të tij anglo-francez. Me formën e tyre të hijshme dhe me hundët e pjerrëta – të nevojshme për të ruajtur aerodinamikën e fluturimit dhe vizibilitetit gjatë ngritjes dhe uljes – të dy u bënë simbole të aviacionit në shekullin e 20-të. Më 26 dhjetor 1975, Tu-144 hyri në shërbim, duke transportuar postën midis Moskës dhe kryeqytetit të atëhershëm

jashtë Bashkimit Sovjetik ishte në tre shfaqje ajrore në Le Bourget në vitet 1970 – dhe një nga ato raste përfundoi me një përplasje që vrau 14 vetë. Dy të tjerë vdiqën në një tjetër rrëzim në vitin 1978. I rrënuar me çështjet e sigurisë dhe me humbje, Tu-144 përfundoi karrierën e tij të pasagjerëve pas vetëm tetë muajsh dhe 55 fluturimesh. Herë pas here barte ngarkesa deri në vitin 1999, kur “u pensionua”.

Burani, anija kozmike sovjetike

Një nga fushat ku u përdor Tu-144 ishte aeronautika, për të trajnuar ekuipazhet për anijen



qiell. Ai u zhvillua me raketën ‘Energia’ – më e fuqishmja që Bashkimi Sovjetik kishte ndërtuar ndonjëherë.

Fluturimi i parë dhe i vetëm i Buranit ishte unik, pasi ishte i pa pilotuar, i kontrolluar nga ngritja e terrenit deri në ulje. Ai fluturoi rreth Tokës dy herë në katër orë dhe u ul në mënyrë të sigurtë – përgjithmonë. Ndërsa Bashkimi Sovjetik u shpërbë, ekonomia e detyroi programin të pezullohej për një kohë të pacaktuar në vitin 1993.

An-225 Mriya, aeroplani më i rëndë i ndërtuar ndonjëherë

Transportimi i Buranit u bë duke e hipur në “shpinën” e Antonov An-225 Mriya (“Endërr” në gjuhën ukrainase). I projektuar në Republikën e Ukrainës me qëllimin fillestar të bartjes së anijes sovjetike, ai bëri fluturimin e parë në vitin 1988 dhe hyri në shërbim të plotë në vitin 1989. Me një gjatësi mbresëlënëse prej 84 metrash dhe hapje krahësh prej 88.4 metrash, është një nga aeroplanët më të mëdhenj që është ndërtuar në botë.

Vetëm një nga këta gjigandë fluturues u ndërtua dhe u bë përpjekje nga ndërmarrje nga

disa qytete në të gjithë Rusinë dhe Ukrainën (të gjitha pjesë e Bashkimit Sovjetik në atë kohë). I aftë për mbajtjen e 390 ton ngarkesash, ai bëri të mundur lëvizjen e shumë pjesëve ajrore.

Ai mbetet i vetmi “Mriya” që ka funksionuar deri më sot, i drejtuar nga Antonov Airlines i Ukrainës dhe e kontraktuar për të kryer lëvizjen e pajisjeve masive industriale dhe ushtarake.

“Përbindëshi” i Detit Kaspik

Para “Mriya-s”, avioni më i rëndë ishte KM (shkurt për “?????-?????” ose “Anija Prototip”) – një mjet unik sovjetik me efekt tokësor i ndërtuar në vitet 1960.

Sigurisht, ai nuk mbajti ngarkesa shumë të larta në ajër – pasi ishte dizajnuar për të fluturuar ulët, duke përdorur forcën rritëse që lindte mes krahëve dhe sipërfaqes së tokës ose ujit.

I quajtur “Përbindëshi” i detit Kaspik (ose KM në rusisht), prototipi mund të mbante deri në 304 ton ngarkesë dhe arrinte shpejtësi mbi 400 km/h. Ai u zhvillua dhe u ndërtua në fshehtësi dhe iu nënshtrua 15 vjet fluturime

provash në Detin Kaspik.

Në vitin 1980 krijuesi i tij vdiq nga plagët gjatë testimit të një makine tjetër të efektit tokësor dhe po ashtu u zhduk edhe përbindëshi i detit Kaspik. Gabimi i pilotit e la atë të dëmtuar dhe mjeti lundroi në ujë për disa ditë, para se të fundosej, për të mos u nxjerrë kurrë.

Lenini, akullthyesi i parë bërthamor

Në vitin 1957, Bashkimi Sovjetik lëshoi një shkëndijë revolucionare në praktikën e pastrimit të korsive të ngrira në det, duke nisur ndërtimin e akullthyesëve me bazë bërthamore. Kombinimi i dy gjërave që Rusia ka me bollëk – akull dhe uranium – ishte “Lenini”, një akullthyes që bëri revolucion duke krijuar një prioritet unike të ndërtimit të anijeve.

I fuqizuar nga dy reaktorë dhe katër turbina, “Lenini” hapi akullin përgjatë brigjeve veriore të Bashkimit Sovjetik për më shumë se 30 vjet dhe lundroi më larg në veri se çdo anije sipërfaqësore përpara saj. Ai doli në “pension” në vitin 1989.

(gazeta-Shqip.com)




të Kazakistanit Alma-Ata (tani Almati). Dy vjet më vonë ai transportoi pasagjerët e tij të parë përgjatë së njëjtës rrugë. Fluturimi prej 3,200 km zgjati rreth dy orë – dy herë më shpejt se ç’ndodh me avionët e zakonshëm.

Krijuesit e Tu-144 kishin plane të mëdha. Hartat u hartuan me rrugë ajrore supersonike që lidhin Moskën me të gjithë globin, përfshirë Evropën, Japoninë dhe Kubën. Por të vetmet herë që ai fluturoi

sovjetike Buran. I konceptuar në vitin 1973, Burani duhej të konkurronte me programin amerikan të hapësirës, duke transportuar ekupe dhe ngarkesa në orbitë dhe mbropa.

Zhvillimi kërkonte një përpjekje masive, duke përfshirë rreth 2.5 milionë njerëz nga i gjithë Bashkimin Sovjetik. Fluturimi i parë ishte planifikuar për vitin 1984, por duhej të tërhiqej, derisa në vitin 1988 Burani më në fund u ngjiti në



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Medium
Service
Pervi



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

AL WEHDA V AL AHLI JEDDAH

2

MELBOURNE VICTORY - WELLINGTON

2

ZAMALEK - PETROJET

2

Gashi: Besa nuk ka krizë, rikthehet në Superligë

Trajneri i Besës, Fisnik Gashi, e ka mohuar krizën në skuadrën pejane, kurse ka konfirmuar se kjo skuadër do të rikthehet në Superligën e Kosovës në futboll. "Për edicionin vjeshtor mund të them se jam i kënaqur me atë që kemi treguar dhe arritur. Pas xhiros së katërt unë emërohem trajner dhe në dymbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara kemi regjistruar tetë fitore dhe katër barazime. Rezultatet dhe paraqitjet e skuadrës sonë kanë qenë të mira, ku përfunduar në pozitën e dytë. Sa i përket eliminimit nga Kupa, ne si shtab teknik dhe kryesia e klubit nuk kemi qenë të interesuar të luftojmë në të dy frontet, pasi synimi i klubit është inkuadrimi në Superligë", ka thënë Gashi.



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 27 DHJETOR - KF Besa e përfundoi sezonin vjeshtor në vendin e dytë në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Trajneri i kësaj skuadre, Fisnik Gashi, të enjten për "Epokën e re" ka thënë se rezultatet e arritura në sezonin vjeshtor nga skuadra e Besës kanë qenë të kënaqshme, kurse eliminimin nga gara e Kupës e ka arsyetuar me faktin se Besa ka synim vetëm rikthimin në Superligë. "Për edicionin vjeshtor mund të them se jam i kënaqur me atë që kemi treguar dhe arritur. Pas xhiros së katërt unë emërohem trajner dhe në dymbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara kemi regjistruar tetë fitore dhe katër barazime. Rezultatet dhe paraqitjet e skuadrës sonë kanë qenë të mira, ku përfunduar në pozitën e dytë. Sa i përket

eliminimit nga Kupa, ne si shtab teknik dhe kryesia e klubit nuk kemi qenë të interesuar të luftojmë në të dy frontet, pasi synimi i klubit është inkuadrimi në Superligë", ka thënë Gashi. Ish-mesfushori i suksesshëm me Besën e Pejës ishte edhe trajneri i Lugut të Baranit. Ai nuk hezitoi të flasë edhe për konkurrentët kryesorë të Besës në Kosovës në futboll. "Si skuadra favorite për t'u rikthyer në elitë, përveç Besës, i shoh edhe Vushtrrinë, Vëllaznimin dhe Dukagjinin, por pa harruar edhe skuadrën e Vitisë e cila është cilësore. Rezultatet në sezonin vjeshtor konfirmojnë se edhe ky klub ka synime të mëdha në pranverë", ka shtuar ai. Ditë me parë është raportuar se Besa është duke kaluar nëpër një krizë dhe disa nga lojtarët kryesorë e kanë kërkuar shpëtimin e kontratës me këtë klub në Federatën e Futbollit të

Kosovës. Gashi ka mohuar të ketë krizë në klubin pejan, kurse për largimin e futbollistëve mendon se janë normale si gjithkund në botë. "Nuk ka krizë te Besa dhe lojtarët që kanë kërkuar të largohen është normale në futbollin profesionist, pasi lojtarët mund të mos e gjejnë veten në një klub dhe kërkojnë angazhim te ndonjë klub tjetër", ka shtuar ai. I pyetur se a priten transferime në afatin kalimtar të janarit, Gashi është përgjigjur: "Sa iu përket transferimeve në muajin janar jemi në përcjellje të disa lojtarëve dhe besoj se para datës 10 janar do t'i finalizojmë marrëveshjet me ata lojtarë që kemi nevojë". Skuadra e Besës që është ndër skuadrat me traditë në futbollin e Kosovës. Sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e dytë me 35 pikë, tri me pak se Vushtrria dhe dy më shumë se Dukagjini i Klinës.

SHKURT

Kelmendi ndahet me Llapin, afër marrëveshjes me Dritën

Sulmuesi Shend Kelmendi e ka përfunduar aventurën në skuadrën e Llapit, kurse tash është futbollist i lirë. Llapi ka njoftuar për ndërprerjen e marrëveshjes me pëlqim të dyanshëm. Kelmendi ka qenë pjesë e kësaj skuadre në gjashtë muajt e fundit ku realizoi një gol dhe dy asistime. KF Llapi e ka falënderuar Shendin për kontributin e dhënë për klubin gjatë kësaj periudhe dhe i ka dëshiruar suksese në vazhdim të karrierës futbollistike. E ardhmja e ish-sulmuesit të Prishtinës pritet të jetë Drita e Gjilanit.

Ajeti: Ishte e drejtë që zgjodha Zvicrën

Tabloidi zviceran "Blick" i ka kushtuar një hapësirë të veçantë sulmuesit të Baselit, Alban Ajeti, që është vëllai i mbrojtësit të kombëtares kuqezi, Arlind Ajeti. Ai e konsideron të drejtë vendimin që zgjodhi Zvicrën, por Shqipëria mbetet shtëpia e familjes. "Shqipëria dhe Zvicra janë shtëpia e familjes sime. Megjithatë, vendosa të luaj për Zvicrën dhe jo për Shqipërinë. Ishte e drejtë që zgjodha Zvicrën", ka thënë Ajeti.

Ronaldo kundër koreve raciste

Edhe Cristiano Ronaldo "zbret në fushë" kundër racizmit në futboll. Kampioni portugez ka postuar në rrjetet sociale një foto ku shfaqet në një duel me mbrojtësin e Napolit, Koulibaly. Edhe mesazhi, i shkruar në gjuhën italiane, ishte mjaft domethënës. "Në botë dhe në futboll duhet të jesh gjithmonë i edukuar dhe të tregosh respekt. Jo racizmit dhe çdo lloj ofendimi dhe diskriminimi", ka thënë Ronaldo.

Partizani largon Statovcin

Aventura e Rron Statovcit te Partizani mund të përfundojë përkohësisht, pasi që mbrojtësi prishtinas nuk preferohet nga trajneri Skënder Gega dhe me shumë mundësi do të përfundojë sërish në Superligën e Kosovës. Siç raporton e përditshmja sportive "Panorama Sport" në Shqipëri, tashmë Statovci pritet të jetë largimi i radhës nga Partizani pas Uakillit dhe Gjojkoviçit. 21-vjeçari nga Prishtina erdhi me bujë në verën e këtij viti, por Gega i besoi sërish Labinot Ibrahimit pozicionin e mbrojtësit të djathtë, madje duke mos e grumbulluar Statovcin në asnjë takim të Superiores.

Inter - Napoli, humb jetën tifozi zikaltër

MILANO, 27 DHJETOR - Sfida e polemikave mund të quhet ajo në mes të Interit dhe Napolit që u luajt të enjten në mbrëmje, ku fitorja u buzëqeshi zikaltërve në fundin e takimit me golin e Lautaros.

Megjithatë, ngjarjet jashtë fushës janë të shumta. Një tifoz i Interit ka ndërruar jetë pas takimit. 35-vjeçari është dërguar në spital pas përplasjes me tifozët napoletanë. Një fugon me tifozë nga Napoli i ka

bllokuar rrugën dhe e kanë goditur me shkopin e zinxhirë. Atij i është dhënë ndihma e parë, por nuk ka arritur të mbi-jetojë. Gjithashtu, katër të tjerë janë plagosur me thikë, por janë jashtë rrezikut për jetën.



Messi: E dija që nuk isha në garë për "Topin e Artë"

BARCELONË, 27 DHJETOR - Argentinasi Lionel Mesi u rendit i pesti në garën për "Topin e Artë", por duket se këto janë gjëra që nuk e shqetësojnë argentinasin. Ai e ka konsideruar rivalitetin me

Cristiano Ronaldon si të shëndetshëm për tifozët. Të dy kanë fituar shumë në La Liga, derisa portugezi vendosi të largohej. Për "Marca", ylli i Barcelonës u shpreh: "Rivaliteti me Cristianon

ishte shumë i shëndetshëm dhe i mirë për tifozët". Secili prej tyre e ka fituar çmimin individual të "Topit të Artë" nga pesë herë, kurse Luka Modriq theu këtë hegjemoni. "Dëgjova për kandidatët

dhe e dija se nuk isha në garë. Unë e dua futbollin, por familja është mbi të gjitha", përfundoi Messi, duke nënvizuar se, përpos gjithçkaje, ai ka prioritetet më madhore në jetë se futbollin.



Shaqiri meritator për formën e lartë të Liverpoolit

LIVERPOOL, 27 DHJETOR - Liverpooli është duke kaluar në një formë të mrekullueshme këtë sezon, duke arritur t'i largohet Manchester Cityt për shtatë pikë, i cili është në pozitën e dytë të Premierligës. Një nga lojtarët që ka ndikuar shumë në këtë formë është Xherdan Shaqiri dhe këtë gjë e dëshmojnë statistikatat e tij për klubin anglez. Zvicerani me origjinë shqiptare arriti ta sigurojë një transferim në Liverpool nga Stoke City para pesë muajve, pasi ish-klubi i tij ra nga Premierliga në Championship. Shaqiri kishte qenë golashënuesi më i mirë në skuadrën e Stoke Cityt me tetë gola. Fillimisht ishte vënë në dyshim nëse Shaqiri e kishte aftësinë dhe etikën e punës që kërkohet për të luajtur për një trajner si Jurgen Kloppi. Megjithatë, në një intervistë pas njëres nga ndeshjet e këtij sezoni, Kloppi kishte thënë se Shaqiri i ka kaluar pritshmëritë e tij. Përkundër që ai nuk aktivizuar në të gjitha ndeshjet e Liverpoolit këtë sezon, statistikatat e tij dëshmojnë se kur Shaqiri luan me "treshen e madhe", Mohamed Salahun,




Sadio Manen dhe Roberto Firminon, askush nuk mund t'i ndalojë djelmoshat e Kloppit. Kjo katërshe është kombinuar në tetë ndeshje të këtij sezoni dhe Liverpooli i ka fituar të gjitha ato. Jo vetëm që klubi anglez i ka fituar plot 24 pikë me këta lojtarë, gjatë këtyre ndeshjeve janë shënuar 22 gola. Statistikat më të mira për më së pakti minuta të kaluar për ta shënuar një gol ka Shaqiri, i cili ka

arritur ta shënojë gol çdo 119 minuta lojë. Për më tepër, kur Shaqiri, Mane, Salah dhe Firmino luajnë bashkë, Liverpooli e shënon një gol çdo 28 minuta. Ky sulm i mrekullueshëm nuk i ka dëmtuar as mbrojtësit, pasi Virgil Van Dijk ka arritur t'i ndihmojë Alissonit ta mbajë portën e paprekur në këto ndeshje. Alisson i ka pranuar vetëm shtatë gola gjatë këtij sezoni.

Toronto dikton renditjen në Lindje, fitojnë edhe San Antonio e Clippersi

MIAMI, 27 DHJETOR - Skuadra e Torontos vijon të dominojë në renditjen e Konferencës së Lindjes, duke korrur fitoren e 26 sezonale, 106-104 në fushën e Miami Heat. Një sukses i vështirë për ekipin kanadez, që vuajti shumë për ta mundur skuadrën nga Florida. Leonard me 30 pikë ishte shënuesi më i mirë për Toronton, autor i 30 pikëve. Pas dy kohëve shtesë fiton skuadra e Brooklynit, që në fushën e saj mundi 134-132 Charlotten, sfidë emocionuese dhe me rivalitet deri në fund. Dinwiddie me 37 pikë e



11 asistime ishte lojtari më i mirë për Brooklyn, mbështetur nga Harris me 27 pikë, ndërsa 35 pikët e Walkerit për miqtë mbetën për statistikë. Fiton edhe ekipi i San Antonios, që mposhti 111-103 Denverin, një përballje mes dy ekipesh pretendente për titull në Konferencën e Lindjes, e dominuar nga basketbollistët e Spursit. DeRozan me 30 pikë e Aldridge me 27 bënë diferencën në fushë për vendësit, që hynë në zonën e "play-

off"-it. Clippersi mund 127-118 Sacramenton, sfidë ku u dallua Williamsi me 24 pikë. Dallasi, falë 21 pikëve e 10 asistimeve të Donqiqit si dhe 20 pikëve e 12 reboundeve të Jordanit, mundi 122-119 New Orleansin, sfidë me shumë emocione deri në fund. Skuadra e Minnesotas mposhti 119-94 Chicago, takim i dominuar nga miqtë, me Rose që realizoi 24 pikë, mbështetur edhe nga Townsi, autor i 20 pikëve e 20 reboundeve.

SHKURT

Spalletti: E merituar fitoren ndaj Napolit

Interi ka marrë një fitore të rëndësishme ndaj Napolit në Serinë A. Skuadra e Luciano Spallettit ka qenë më mirë se kundërshtarët gjatë supersfidës së 'San Siro'-s dhe trajneri italian mendon se djemtë e tij e kanë merituar fitoren ndaj vendit të dytë. "Ishte një Inter i fortë që nga minuta e parë e deri në fund. Fituar me meritë. Ishte ndeshje e bukur. Jam i kënaqur", ka thënë Spalletti, i cili ka lavdëruar sulmuesin Lautaro Martinez dhe mesfushorët Nainggolan dhe Joa Mario.

Sarri krahason Hazardin me Messin dhe Ronaldon

Trajneri i Chelseat, Maurizio Sarri, e ka krahasuar Eden Hazardin me Lionel Messin dhe Cristiano Ronaldon. Sulmuesi belg shënoi dy golat e fitores në ndeshjen ndaj Watfordit. "Ai është shumë i rëndësishëm për ne. Messi është shumë i rëndësishëm për Barcelonën, Cristiano Ronaldo është shumë i rëndësishëm për Juventusin", ka thënë Sarri, duke konfirmuar se Hazardi po luan shumë mirë në pozitën si "9 fals".

Ancelotti: Kemi kërkuar tri herë ndërprerjen e ndeshjes

Trajneri i Napolit, Carlo Ancelotti, ka thënë se ka kërkuar tri herë nga gjyqtari që të suspendohet ndeshja në mes të Interit dhe Napolit pas abuzimeve raciste nga fansat e Interit në drejtim të mbrojtësit Kalidou Koulibaly. Ky i fundit u ndëshkua me karton të kuq, pasi kishte duartrokur me ironi gjyqtarin. "I kam kërkuar informacione në lidhje me kartonin e kuq të Koulibalyt, që ka vendosur ndeshjen, sipas mendimit tim. Kemi mbetur me 10 lojtarë dhe kjo na ka kushtëzuar, edhe pse kemi shkuar afër golit", ka thënë Ancelotti. "Kemi kërkuar tri herë ndërprerjen e ndeshjes, Koulibaly është nervozuar, është normale. Zakonisht është i edukuar dhe profesionist. Spikeri i stadiumit ka bërë tri lajmërimet, por nuk është bërë asgjë më shumë. Zgjidhja? Herën tjetër do të largohemi nga fusha dhe do ta humbim ndeshjen në tavolinë. Nuk është një justifikim, nuk ka lidhje vetëm me Napolin, por me gjithë futbollin italian", ka deklaruar Ancelotti.

Giggs e Neville: Solskjaer po i kthen në formë yjet e skuadrës

Ryan Giggs dhe Gary Neville kanë vetëm fjalë të mira për punën e bërë të trajnerit të ri, Ole Gunnar Solskjaer, në krye të Manchester Unitedit. Ka qenë fillimisht Ryan Giggs që ka thënë se yjet si Paul Pogba dhe Marcus Rashford po e shfaqin më së miri potencialin e tyre. Lojtarët nën Jose Mourinhon kishin humbur motivin për të luajtur, ndërsa marrëdhënia e trajnerit me lojtarit nuk ishte më e mira. "Ishte ndeshja e parë në shtëpi për Ole si trajner. Gjithçka shkoi pozitivisht. Performanca dhe rezultati ishin të kënaqshme. Mendoj se të gjithë e prisnin këtë kthesë të skuadrës. Lojtarët e mëdhenj janë duke u kthyer si të tillë. Pogba me golat e tij, Davidi me formë të shkëlqyeshme në portë dhe Marcus po bëhet gjithnjë e më i mirë në çdo lojë". Edhe Neville ka vetëm fjalë të mira, ndërsa e cilëson Pogban si mesfushorin më të mirë në Evropë. "Ata kanë lojtarin më të mirë në fushë, ndoshta mesfushorin më të mirë në Evropë. Paul Pogba po shkëlqen, por duke mos i harruar 18 muajt zhgënjyes që erdhën për shkak të marrëdhënieve me trajnerin", ka deklaruar Neville.

REZULTATET

Detroit - Washington	106-95
Orlando - Phoenix	120-122
Atlanta - Indiana	121-129
Brooklyn - Charlotte	134-132
Miami - Toronto	104-106
Chicago - Minnesota	94-119
Memphis - Cleveland	95-87
Dallas - New Orleans	122-119
San Antonio - Denver	111-103
Clippers - Sacramento	127-118

	Autor: GAZMEND MORINA		AKTORI AMERIKAN STILLER	JURIST QË JEP NDIHMË E KËSHILLA PËR ÇËSHTJE TË DREJTËSISË	JEVG	IVAN KLASNIÇ	KËNGËTARJA ANGLEZE TANITA	▼	KRYENGRITË-SI QË DILTE MALIT E LUFTONTE MINDERI I ULËT (vjet.)	IVREA	EPOKA ERE	BIMË SHUMËVJE-ÇARE ME TRUNG TË TRASHË	LLOJ BIME NARKOTIKE
	ZËRI I BURRIT NDËRMJET TENORIT DHE BASIT										DY BASHKË-TINGËLLORE DRAMË E SANTORIT		
	NGJALLJA E KUJTIMEVE PËR DIKË									EPOKË (shq.)			
	KANUN, LIGJ (vjet.)					AKTROJA AMERIKANE BASINGER SHTET I MADH NË AZI				SEKRETARI I OKB-së BAN KI QË ËSHTË LARA-LARA NË TRUP (për kafshët)			
	EPOKA ERE		BASHKËT. SHPREHET ME FJALË		GJAKATARI BIXHOZ							ZANORE MALI MË I LARTË NË TURQI	
	NJERI I VARFËR QË ËSHTË PËR T'U MËSHIRUAR (shq.)								BANORI I ARABISË SAUDITE VARGU I KURANIT				
	▶							BUJKU KËNGËTARJA BERISHA					
KËNGËTARJA SEJDIU ZANORE			NËNA VEPRIMTARI ZEZAK MARTIN KING							ANTIGONA SEJDIU OLIVIER MARTINEZ			
EPOKA ERE	DIÇKA QË BURON NGA DIÇKA TJETËR	I SPËRKATA ME UJË	BOKSIERI I NJOHUR KLITSCHKO	“Z” në mes të dy “A”	PAKTI USHTARAK MË I MADH NË BOTË	TEXAS LIBRARY ASSOCIATION IDRIZ BALAJ			REGJISORI ... QOSJA	TËRËSIA E ORENDIVE SMIRA			
KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT (shq.)							PËRGËZIMET SHTET (FR.)				MIMOZA AHMETI AKTORJA AJETI		AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ... FARIS
AKTORJA E FAMSHME AMERIKANE NË FOTO OLSEN (shqip.)								KËNGËTARI ARIFI ENË E METALTË PËR TË SKUQUR VAJIN				TONI ADAMS QYTET I SHENJTË I MYSLIMANËVE	
KËSTET BANKARE PËR KTHIMIN E KREDISË						GRADË USHTARAKE QË KA TË BËJË ME FSHATIN				REGJISORI HALILI PUNËTOR I TEATRIT TË KUKULLAVE			
▶				KOHA E NDARË PËR PUNË POLITIKANI FERID				JETËSHKRIM ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHEARER (origj.)				ARMENIA UNITED PROGRESIVE ALLIANCE	
SHIU I IMËT DALLGA					UMA TURMAN AKTORI EGJIPTIAN SHARIF		BISHTUK ME VAJGURI (shq.) QË KA MBUSHUR NJË VIT, MOTAK						PRAPË
ARTANA		ISH MUZIKANTI RUS STRAVINSKI GDHENDUR, LATUAR				PYLLI PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT (pashq.)				I ÇELA ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER			
DY BASHKË-TINGËLLORE			FEMRA LUFTËTARE QË NUK MARTOHEJ (mit greke) PORËSIA E FUNDIT						MA JEP INSTITUCION I LARTË SHKENCOR			AGIM POSHKA KALI I SHALËS	
EPOKA ERE	HENDEK PËR TË UJITUR (sh.shq.) LLOJ SHALE DRURI							ANIJATA HARAÇ				ZANORE ALBANOLOGIA DURHAM	
FUTBOLLISTI FRANCEZ NASRI (MANCHESTER CITY)						SHEGË LUMË NË SHQIPËRI		BRINJËT QË FORMOJNË KËNDIN E DREJTË TË TREKËNDËSHIT SHEJTAN					
ALUMIN, AMPER				KLUB FUTBOLLI NË GREQI	PAJISJA E VETURËS SË LËSHON TINGUJ REOMIR, INDIUM					OSAKA RROGË VJETORE E PAPËS	IVAN DIXON QË I PËRKET ETIKËS		BALTA E QULLËT, GJANA
KULLË E XHAMISË							SHKRIMTARI ISMAIL STUDENT AID REPORT					IGLESIAS GABRIEL NJËSI E VJETËR PESHE	
ZBRITJE E AEROPLANIT NË TOKË							ELEMENT KIMIK (SE)				FUTBOLLISTI FRANÇESKO (ROMA) TITAN		
PUNA E PËRDITSHME, ZAKONISHT E MËRZITSHME, PA ASNJË NDRYSHIM							ATEMOR, JO TEMATIK ZANORE					BASHKËT. KRUJA	
REGJISORJA ELEZI					HIJESHI, BUKURI QË TË BËN PËR VETE			LIQEN I MADH NË AMERIKËN JUGORE					



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SIISKUK)-Univerzitetske Bolničke i
Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)-I Hospital and University Clinical Service of Kosovo (IIUCSK)
Sektori i Personelit të SIISKUK-së

Nr.79 datë:27.12.2018, Prishtinë

Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 4, paragrafi 1,2,3,4,5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik, nenit 13 paragrafi 1 dhe 3 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar e Kosovës, (SHSKUK), si dhe nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi, nenit 5 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003 datë 21.07.2016, Emailit dt:27.12.2018 , Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së shpall:

KONKURS
Publik

Institucioni: Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SIISKUK)
Sektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Donacione në

SHSKUK

Titulli i vendit të punës: 1. Zyrtar/e për bashkëpunim ndërkombëtar dhe koordinim të donacioneve të SHSKUK-së (1 pozitë)

Raporton: Shefit të Sektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Donacione të SHSKUK-së

Kohëzgjatja e kontratës: pa afat të caktuar
Periudha provuese: 90 ditë sipas KKS-së
Koeficienti i pagës: 8.4
Orari i punës: 40 orë në javë
Nr. i Referencës: DP-SHSKUK - 04/2018-12/1

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Zyrtar/e për bashkëpunim ndërkombëtar dhe koordinim të donacioneve

Nën udhëheqjen e Udhëheqësit/es të sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe koordinim të donacioneve të SHSKUK, zyrtari/ja për bashkëpunim ndërkombëtar dhe koordinim të donacioneve, ndihmon Udhëheqësin/en e sektorit në kryerjen e punëve dhe aktiviteteve ditore për të siguruar drejtimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe donacioneve në dobi të SIISKUK-së, gjegjësisht QKUK-së, spitaleve të përgjithshme dhe institucioneve tjera përbërëse të SHSKUK-së.

Përgjegjësitë kryesore:

- Ndihmon Udhëheqësin/en e sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe koordinim të donacioneve në kryerjen e punëve të përditshme të sektorit
- Ndihmon në organizimin dhe procedimin e kërkesave për bashkëpunim ndërkombëtar sipas kërkesës së njësisë të ndryshme të SHSKUK
- Shpërndan te njësitë relevante në SHSKUK kërkesat për bashkëpunim ndërkombëtar/dhënie të donacioneve të ofruara nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare
- Ndihmon në shqyrtimin e kërkesave për donacione duke i drejtuar në njësitë relevante
- Ndihmon në përgatitjen e marrëveshjeve për bashkëpunim ndërkombëtar për donacione, asistencë teknike etj.
- Ndihmon në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për procedurat e pranimit dorëzimit si dhe importimit të mallrave për donacion
- Ndihmon në hartimin e dokumentacionit për donacionet në infrastrukturë
- Ndihmon në hartimin e rregulloreve për pranimin e donacioneve
- Ndihmon në hartimin e rregulloreve për bashkëpunim ndërkombëtar
- Kryen të gjitha përgjegjësitë administrative të sektorit që kanë të bëjnë me logjistikën, furnizimin etj
- Kryen funksione tjera sipas nevojës

Kualifikimi dhe përvoja e kërkuar:

- Fakulteti i mjekësisë ose stomatologjisë
- Shkathtësi organizative dhe komunikimi në të shkruar dhe në të folur
- Përvojë pune së paku 3 vite.
- Shkathtësi kompjuterike
- Njohje e shkëlqyer e gjuhës angleze është e domosdoshme
- Letërnjoftim - fotokopje
- Certifikatë të lindjes.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat të kërkuar me konkurs si dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar sipas këtij konkursi.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në njërin nga mjetët e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit të SHSKUK/QKUK-së.

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Kandidatët të cilët aplikojnë të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarsvo Zdravstva - Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SIISKUK)-Univerzitetske Bolničke i
Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)-The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Nr.79 datë:27.12.2018, Prishtinë

Prema članu 8 Zakona, tačka 1 i 2 o radu br. 03/L-212, član 4, tačka 1,2,3,4,5 Administrativno Uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, člana 13. Tačka 1 i 3 Statuta Bolničke Službe i Univerzitetskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK), kao i član 62, stav 6, Zakona br. 04/L-125, o Zdravstvo, Član 5, Uredbe o radnim odnosima br. 1003 datum 21.07.2016, i sa Emaila datom 27.12.2018, Generalnog Direktora UBKSK, objavljuje

KONKURS

Institucije: Universitetski Bolničke i Kliničke Službe Kosova. (UBKSK)
Sektora za međunarodnu saradnju i koordinaciju donacija

Naziv radnog mesta: 1 Službenik/ca za međunarodnu saradnju i koordinaciju donatora

Validitet ugovora bez fiksnog roka
Koeficijent plate (plata): 8,4
Izveštava: Sef Sektora za međunarodnu saradnju i koordinaciju donacija (UBKSK)
Radno vreme: 40 časa nedeljno
Referentni broj: GD-UBKSK - 04/2018-12/1

Službenik/ca za međunarodnu saradnju i koordinaciju donatora:

Pod rukovodstvom Rukovodioca za međunarodnu saradnju i koordinaciju donacija UBKSK, službenik/ca za međunarodnu saradnju i koordinaciju donatora pomaže Rukovodioca sektora u obavljanju svakodnevnih aktivnosti i aktivnosti kako bi se osigurao pravac međunarodne saradnje i donacija u korist UBKSK, odnosno UKCK-a, opštih bolnica i drugih konstitutivnih institucija UBKSK.

Glavne odgovornosti:

- Pomoć rukovodiocu/ci Sektora za međunarodnu saradnju i koordinaciju donacija u radu u svakodnevnoj sektora,
- Pomoći u organizaciji i obradi zahtjeva za međunarodnu saradnju na zahtjev različitih jedinica UBKSK,
- Distribuirati relevantnim jedinicama UBKSK, uslove za međunarodnu saradnju / donacije koje pružaju razne međunarodne institucije,
- Pomoći u razmatranju zahtjeva za donacijama upućivanjem na relevantne jedinice,
- Pomoći u pripremi međunarodnih sporazuma o saradnji sa donatorima, tehničkoj pomoći itd.
- Pomagati u izradi potrebne dokumentacije za postupke isporuke kao i za uvoz robe za donaciju,
- Pomaže u izradi dokumentacije o donacijama infrastrukture,
- Pomaže u izradi propisa o prihvatanju donatora
- Pomagati u izradi propisa o međunarodnoj saradnji
- Obavlja sve administrativne odgovornosti u sektoru koji se odnosi na logistiku, snabdijevanje, itd.
- Obavlja druge funkcije po potrebi.

Potrebna kvalifikacija i iskustvo:

- Fakultet Medicinski ili Stomatološki,
- Organizacione veštine i komunikacija u pisanom i govornom obliku,
- Radno iskustvo od najmanje 3 godine,
- Kompjuterske veštine,
- Odlične veštine engleskog jezika su neophodne,
- Ličnakarta
- Certifikat o rođenju.

Uslovi učešća u zapošljavanju: pravo da se prijave svi su državljani Republike Kosova odraslih koji imaju punu pravnu sposobnost, su završili svoje obrazovanje i imaju adekvatnu stručnu sposobnost koje zahteva sa konkursom za obavljanje zadataka.

Zbornik radova konkursa: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate, prema ovom konkursu.

Datum zatvaranja konkursa: 15 dana od dana objavljivanja u jednom od javnih novinama.

Podnošenje prijave: Aplikacija se uzimaju i dostavljaju kadrovskom odeljenju UKCK.

U prijavi treba jasno navesti naziv radnog mesta i referentni broj. Svi profesionalni dokumenata i dokaza prilaže uz zahtev.

Prijave podnete po isteku roka i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Kandidati pruži dokaze pod objavljivanjem konkursa, kandidati koji inače ne ispunjavaju uslove konkursa neće biti pozvan na intervju .

Generalnog Direktora UBKSK

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRI/ / OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

Vazhdim i Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Titulli i punës:	Shërbime Auditimi
Paga mujore:	Sipas marrëveshjes
Raporton te:	SIDA/ABGJ
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Sipas marrëveshjes

Termat Standarde të Referencës¹, për Auditimin Vjetor në mbështetje të Programit/Projektit.

Agjencia për Barazi Gjinore dëshiron të angazhojë shërbimet e një Firme Audituese me qëllim të auditimit të “Mbështetjes për Agjencinë për Barazi Gjinore në Kosovë, 2015- 2019 ”, siç përcaktohet në Marrëveshjen ndërmjet Agjencisë për Barazi Gjinore dhe Sida-s.

Auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të auditimit të lëshuara nga IAASB²,nga një auditor i jashtëm, i pavarur dhe i kualifikuar (Kontabilist Publik i Miratuar / Kontabilist Publik i Autorizuar ose ekuivalent).

Objektivi: Auditimi i Raportit Financiar për periudhën (01.01.2018 deri 31.12.2018) i cili dorëzohet në Sida , për një Opinion të Auditimit sipas ISA 800/805 mbi atë nëse Raporti Financiar për Mbështetje të Agjencisë për Barazi Gjinore në Kosovë, 2015-2019”, është në përputhje me Udhëzimin e Sida-s për raportimin financiar sipas Marrëveshjes ndërmjet Sida-s dhe Agjencisë për Barazi Gjinore; Anexi II në marrëveshjen mes ABGJ-së dhe SIDA`s.

¹ Termat e Referencës për angazhimin e auditorit të pavarur, janë hartuar dhe bazuar në detyrimet kontraktuale të specifikuar në Marrëveshjen e Mirëkuptimit të nënshkruar mes Agjencisë për Barazi Gjinore të Kosovës dhe Qeverisë Suedeze, përfaqësuar nga SIDA, më 11/06/2015; Neni 7 dhe shtojca IV e Marrëveshjes.
² Bordi Ndërkombëtar për Standardet e Auditimit dhe Sigurisë (IAASB).

Detyra(caktime) shtesë; në bazë të Procedurave 4400 të dakorduara në Kushtet e veçanta të referencës që do të miratohen nga Sida;

- Përcjellja, nëse kostot e pagave të debituar për Projektin janë të regjistruara përgjatë gjithë kohëzgjatjes së vitit, në mënyrë të sistematizuar dhe shqyrtimi nëse kostot e pagave mund të vërtetohen me dokumente të mjaftueshme mbështetëse³.
- Shqyrtimi, nëse raporti financiar përfshin një krahasim për çdo zë të buxhetit, ndërmjet kostove faktike / shpenzimeve të aktiviteteve dhe kostove / shpenzimeve të projektuara si të miratuara nga Sida për periudhë.
- Në bazë të materialitetit dhe rrezikut, auditori do të shqyrtojë nëse ekziston dokumentacioni mbështetës lidhur me shpenzimet e bëra.
- Përcjellja nëse Agjencia për Barazi Gjinore ka zbatuar rekomandimet sipas planit kohor në rishikimin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit, KPMG, mars 2015: Ekzaminimi përfshinë shqyrtimin nëse Agjencia për Barazi Gjinore ka filluar zbatimin e pikave të renditura të veprimit siç përshkruhet në Planin e Veprimit të Agjencisë për Barazi Gjinore, 21 Prill 2015.
- Shqyrtimi nëse fitimet dhe humbjet nga këmbimi i huaj valutor janë të reflektuara në përputhje me atë që është përcaktuar në marrëveshje, duke përfshirë shtojcat.
- Nëse Agjencia për Barazi Gjinore i është përmbytur Rregullave dhe Rregulloreve të ndërlidhura me tatimet (e.g.PAYE⁴) dhe Tarifat e Sigurimeve Shoqërore.
- Përcjellja nëse Agjencia për Barazi Gjinore ka respektuar udhëzimet e prokurimit të përcaktuara në marrëveshje.
- Shqyrtimi nëse bilanci dalës për periudhën paraprake është i njëjtë si bilanci hyrës për periudhën aktuale.
- Detyra shtesë në përputhje me procedurat e rëna dakord dhe termat e referencës.

Raportimi

Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia e përdorur do të paraqiten në raportin e auditimit. Raportimi duhet të nënshkruhet nga auditori përgjegjës (jo vetëm nga firma e auditimit) dhe titulli. Raportimi nga auditori do të përfshijë raportin e një auditori të pavarur në përputhje me formatin në standardin ISA 800/805 dhe opinionin i auditorit duhet të shprehet qartë, si dhe letra e Menaxhmentit me gjetjet dhe dobësitë e identifikuar gjatë procesit të auditimit. Auditori pa

³ Nëse buxheti përfshin kostot e pagave që do të debitohen për projektin, auditori gjithmonë do të shqyrtojë kostot e pagave të përcaktuara këtu.
⁴ tatimi progresiv mbi të ardhurat/ tatimi i mbajtur në burim.

marrë parasysh materialitetin do të kuantifikojë shumën për kostot në mungesë të dokumentacionit të mjaftueshëm mbështetës. Auditori duhet të bëjë rekomandime për të adresuar çdo dobësi të identifikuar dhe rekomandimet duhet të paraqiten sipas renditjes prioritare. Nëse auditori vlerëson se nuk janë identifikuar gjetje apo mangësi gjatë auditimit që do të rezultojnë në një letër të Menaxhmentit, një shpjegim i këtij vlerësimi duhet të shpaloset në raportimin e auditimit.

Masat e marra nga Agjencia për Barazi Gjinore për të adresuar dobësitë e identifikuar në auditimet e mëparshme gjithashtu do të paraqiten në letërën e menaxhmentit.

Përzgjedhja e Auditorit do te miratohet nga Sida

Detyra shtesë në përputhje me procedurat e rëna dakord sipas paragrafit III do të raportohen në një pjesë të veçantë në përputhje me termat e referencës.

Auditori duhet të dorëzojë:

Një profil të vetin me të cilin dëshmohet aftësia profesionale dhe eksperiencat e mëparshme dhe dëshmia e realizimit të së paku dy auditime te fundit te cilat i ka realizuar;

- Një letër, ku shpreh interesin për të realizuar një projekt të tillë;
- Një Projekt-Propozim të shkurtër i cili duhet të përfshijë:

- 1) Planin dhe kalendarin e detajuar të aktiviteteve të projektit;
- 2) Metodologjinë e punës;
- 3) Dokumentacionin e nevojshëm si dëshmi për burimet e tjera financiare dhe materiale.

Konkursi vazhdohet nga data 28.12.2018 deri me datë 08.01.2019, nga dita e publikimit në web faqen e ABGJ-së : <http://abgj.rks-gov.net/>.

Paraqitja e kërkesave për aplikim do të bëhet në Divizionin për Administratë, Buxhet dhe Financa në adresën: Ndërtesa e Qeverisë, Kati 7 Nr.Zyrës 711 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00.

Për informata më të hollëshme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/200 14 274.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

NJOFTIM

ANULOHET konkursi në Zyrën e Kryeministrit i shpallur me datë 07 dhjetor 2018 për pozitat si në vijim :

- Zyrtar i lartë për Planifikim të Politikave (1 pozitë)
- Zyrtar i lartë për Planifikim Strategjik (1 pozitë)
- Zyrtar I lartë Ligjor (1 pozitë)
- Zyrtar I lartë për koordinim të politikave në SKQ (2 pozita)

Nga pjesëmarrësit në konkurs kërkohmë mirëkuptim.

O B A V E Š T E N J E

Poništava se konkurs u kancelariji Premijera, objavljen dana 07.decembra 2018 za sledeće pozicije:

- Viši službenik za planiranje politike (1 pozicija)
- Viši službenik za strateško planiranje (1 pozicija)
- Viši pravni službenik (1 pozicija)
- Viši službenik za koordinaciju politika u KSV (2 pozicije)

Od učesnika na konkursu tražimo razumevanje.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ / OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

Produzivanje javnog konkursa za ugovor o posebnim uslugama

Naziv pozicije:	Revizorske usluge
Mesečna zarada:	Prema dogovoru
Izveštava kod:	SIDA/ARP
Vrsta ugovora:	Ugovor o posebnim uslugama – (UPU)
Vreme trajanja ugovora:	Prema dogovoru

Standardni projektni zadatak⁵, za godišnju reviziju u podršci Programa/Projekta.

Agencija za rodnu ravnopravnost čeli da angažuje usluge jedne revizorske kompanije u cilju revizije programa „Podrška Agenciji za ravnopravnost polova na Kosovu 2015-2019“, kako se utvrđuje u Sporazumu između Agencije za ravnopravnost polova i SIDA.

Revizija će se vršiti u skladu sa međunarodnim standardima revizije izdatih od IAASB⁶, od jednog spoljnog revizora, nezavisnog i kvalifikovanog (Sertifikovan javni računovođa / Ovlašćen javni računovođa ili ekvivalentan).

Cilj: Revizija finansijskog izveštaja za period (01.01.2018 do 31.12.2018) koji se podnosi u SIDA, za mišljenje revizije prema standardu ISA 800/805 oko toga da li je Finansijski izveštaj „Podrške agenciji za ravnopravnost polova na Kosovu 2015-2019“, u skladu sa uputstvima SIDA o finansijskom izveštavanju prema Sporazumu između SIDA i Agencije za ravnopravnost polova; Aneks II u sporazumu između ARP-a i SIDA.

Dodatne dužnosti (zadaci); na osnovu dogovorenih Postupaka 4400 u Posebnim uslovima reference koji će se usvojiti od SIDA;

⁵ Projektni zadatak za angažovanje nezavisnog revizora je utvrđen i zasniva se na specifične ugovorne obaveze u Sporazumu o razumevanju potpisan od Agencije za ravnopravnost polova Kosova i Vlade Švedske, zastupljena od SIDA, dana 11/06/2015; Član 7. i Aneks IV Sporazuma.

⁶ Međunarodni Odbor za standarde revizije i bezbednosti (IAASB).

- Praćenje, da li su troškovi debitovanih zarada za Projekat evidentirani tokom cele godine, na sistematski način, i razmatranje da li se troškovi zarada mogu potvrditi sa dovoljno pratećim dokumentima⁷.
- Razmatranje, da li finansijski izveštaj obuhvata poređenje za svaku stavku budžeta, putem stvarnih troškova / rashoda aktivnosti i predviđenih troškova / rashoda usvojenih od SIDA za period.
- Na osnovu materijalnosti i rizika, revizor će razmatrati da li postoji prateća dokumentacija u vezi sa urađenim troškovima.
- Praćenje da li je Agencija za ravnopravnosti polova sprovodila preporuke prema dinamici u pregledu interne kontrole i upravljanja, KPMG, mart 2015. Ispitivanje obuhvata da li je Agencija za ravnopravnost polova počela sa sprovođenjem navedenih akcionih tačaka kako se propisuje u Akcionom planu Agencije za ravnopravnost polova, 21. april 2015.
- Razmatranje da li se dobici i gubici od razmene strane valute odražavaju u skladu sa time šta je utvrđeno u sporazumu, uključujući i anekse.
- Da li se Agencija za ravnopravnost polova pridržavala pravilnicima i uredbama koje se odnose na poreze (npr. PAYE⁸) i tarifama društvenih osiguranja.
- Praćenje da li je Agencija za ravnopravnost polova poštovala uputstva javne nabavke, koja su utvrđena u sporazumu.
- Razmatranje da li je bilans uspeha za prethodni period isti kao bilans stanja za trenutni period.
- Dodatne dužnosti u skladu sa dogovorenim postupcima i projektnim zadatkom.

Izveštavanje

Delokrug revizije i korišćena metodologija predstavljaće se u izveštaju o reviziji. Izveštavanje treba da se potpisuje od odgovornog revizora (ne samo od kompanije revizije) i naslova. Izveštavanje od revizora obuhvatiće izveštaj nezavisnog revizora u skladu sa formatom u standardu ISA 800/805 i mišljenje revizora treba jasno da se navede, kao i pismo rukovodstva sa identifikovanim nalazima i manama tokom procesa revizije. Bez obzira na materijalnosti revizor će da kvantifikuje iznos o troškovima u nedostatku dovoljno prateće dokumentacije.

⁷ Ako budžet obuhvata troškove zarada koja će biti debitovana za projekat, revizor će uvek pregledati troškove utvrđenih zarada ovde.

⁸ Progresivan porez na dohodak/ porez održan na izvoru.

Revizor treba da daje preporuke za rešavanje svake identifikovane slabosti a preporuke treba da se predstavljaju po redosledu prioriteta. Ako revizor procenjuje da su identifikovani nalazi ili mane tokom revizije koje će rezultirati u pismu rukovodstva, objašnjenje ove procene treba da se navede u izveštavanju revizije.

Preduzete mere od Agencije za ravnopravnost polova za rešavanje identifikovanih slabosti u prethodnim revizijama takođe će se biti predstavljena u pismu rukovodstva.

Odabir revizora će se usvajati od SIDA

Dodatne dužnosti u skladu sa dogovorenim postupcima prema stavu III izveštavaće se u posebnom delu u skladu sa projektnim zadatkom.

Revizor treba dostaviti:

Svoj profil kojim se dokazuju stručne veštine i prethodno iskustvo i dokaz sprovođenja najmanje dveju revizija, koje je sproveodio:

- Jedno pismo, gde izražava interesovanje da realizuje takav projekat;
- Jedan kratak nacrt projekta, koji treba da obuhvata:

- 1)Detaljan plan i kalendar aktivnosti projekta;
- 2) Metodologiju rada;
- 3) Potrebnu dokumentaciju kao dokaz za druge finansijske i materijalne izvore.

Produzava se konkurs od 28.12.2018 do 08.01.2019, od dana objavljivanja na internet stranici ARP-a : <http://abgj.rks-gov.net/>.

Podnošenje prijava se radi u Diviziji za upravu, budžet i finansije u adresi: Zgrada Vlade, 7. Sprat, Br. kancelarije 711 – Priština, svakog radnog dana od 8:00 – 16:00.

Za detaljne informacije možete kontaktirati ovaj br. tel: 038/200 14 274.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ridvan Mehmeti shpallë të pavlefshme mod-ulin për të cilën është aftësuar kandidati për instalues elektrik.
- Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.
- Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me kor- rektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.